Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raport i Auditimit
të Teknologjisë së Informacionit

SISTEMI I INTEGRUAR INFORMATIV PËR SKEMAT PENSIONALE

Prishtinë, korrik 2026

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji[1] i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000[2] dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100[3]).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit[4], ekonomisë[5], dhe efektivitetit[6] të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

1 Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

2 SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

3 GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI.

4 Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

5 Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë.

6 Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit "Sistemi i Integruar Informativ(SII) për skemat pensionale" në konsultim me Drejtorin e Departamentit të Auditimit, Samir Zymberi, i cili e ka menaxhuar e mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Poliksena Berisha, Udhëheqëse e ekipit;
Agron Hoxha, Anëtar i ekipit dhe
Atdhe Gashi, Anëtar i ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria,
Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
http://zka-rks.org

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme 1
1. Hyrje 5
2. Objektivi dhe fushat e auditimit 11
3. Gjetjet e auditimit 15
3.1.Blerja dhe Zhvillimi 17
3.2.Kontrollet e aplikacionit 24
4. Konkluzionet 39
5. Rekomandimet 43
Shtojca I. Dizajni i auditimit 49
Shtojca II. Letër konfirmimet 65

Lista e shkurtesave

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
API	Ndërfaqe për Programimin e Aplikacioneve (Application Programming Interface)
ARC	Agjencia e Regjistrit Civil
AShAK	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
AShI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
MF	Ministria e Financave
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MPFVLÇ	Ministria e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
PPAK	Pensioni për Personat me Aftësi të Kufizuara
PRF	Plani për Rikthimin nga Fatkeqësia
PVB	Plani për Vazhdimësinë e Biznesit
SII	Sistemi i Integruar Informativ
SQL	Gjuhë e Strukturuar e Kërkesave (Structured Query Language)
TI	Teknologji e Informacionit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Sistemi i Integruar Informativ (SII) për skemat pensionale përfaqëson një komponent thelbësor në administrimin e përfitimeve sociale në Republikën e Kosovës dhe në menaxhimin e një buxheti të konsiderueshëm publik që tejkalon 400 milionë euro në vit. Ky sistem ka për qëllim të mundësojë përpunim efikas, të saktë dhe të drejtë të aplikimeve për pension, duke garantuar realizimin e të drejtave ligjore të qytetarëve për përfitime pensionale në mënyrë të barabartë dhe transparente.

Rezultatet e këtij auditimi tregojnë se ky sistem nuk ka arritur nivelin e pritshëm të zhvillimit, integrimit dhe sigurisë, duke mos arritur të digjitalizohet plotësisht procesi dhe bazat e të dhënave. Mangësitë në mekanizmat e sigurisë, validimin e të dhënave dhe organizimi i tyre në formë të fragmentuar kanë pa-mundësar ndërlidhjen dhe komunikimin mes tyre, duke krijuar sfida të shumta në aspektin e efikasitetit operacional, besueshmërisë dhe cilësisë së të dhënave.

Sistemi i integruar informativ për skemat pensionale nuk ka arritur të sigurojë integrimin e plotë të të gjitha skemave pensionale.

Në aspektin e zhvillimit dhe organizimit të sistemit, është vërejtur se implementimi i tij ka devijuar nga planifikimi dhe objektivat e përcaktuara në fazën e projektimit. Zhvillimi i sistemit është realizuar në mënyrë të pjesshme dhe i ndarë sipas moduleve. Disa skema të pensioneve janë përfshirë në platformën qendrore, ndërsa një pjesë tjetër e skemave është ndërtuar dhe menaxhuar jashtë platformës qendrore, përmes zgjidhjeve të ndara teknologjike, e që kanë zgjedhur format e Microsoft Access. Kjo qasje ka rezultuar në mungesë të një sistemi të unifikuar dhe ka kufizuar mundësinë për menaxhim të centralizuar dhe të qëndrueshëm të të dhënave. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes dhe monitorimit të duhur ka ndikuar që ndryshimet dhe përmirësimet në sistem të mos realizohen në kohë dhe në disa raste të bëhen pa procese të standardizuara të miratimit.

Një problem tjetër thelbësor lidhet me fragmentimin e të dhënave dhe mungesën e digjitalizimit të plotë të proceseve. Të dhënat për skemat pensionale nuk janë të konsoliduara në një bazë të vetme qendrore dhe po ashtu nuk ekziston unifikim

dhe integrim mes bazave të të dhënave të ndryshme. Një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit historik e të dhënave të pensionistëve lidhur me përvojën e punës vazhdon të mbahet në formë fizike në Ministri dhe në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Këto kanë qenë të parapara të dixhitalizohen dhe të integrohen në bazën e të dhënave elektronike, për të dëshmuar në mënyrë efikase përvojën e punës së pensionistëve. Ndërsa gjendja aktuale e bënë verifikimin e të dhënave më të ngadalshëm dhe më të pasigurt për pensionistët.

Në aspektin e menaxhimit institucional dhe teknologjik, është evidentuar mungesa e kontrollit të plotë mbi zhvillimin e sistemeve mbështetëse. Një pjesë e konsiderueshme e funksionaliteteve janë ndërtuar në zgjidhje të veçanta dhe jo të integruara, përfshirë përdorimin e platformave të thjeshta databazë si Microsoft Access, të cilat nuk ofrojnë nivel të mjaftueshëm të integrimit, sigurisë dhe shkallëzueshmërisë. Për më tepër, mungesa e pronësisë së plotë mbi kodin burimor dhe varësia nga palët e jashtme kanë kufizuar institucionin për mirëmbajtjen dhe zhvillimin të mëtejshëm të sistemit.

Mangësitë e kontrolleve në aplikacion për sistemin e integruar informativ për skemat pensionale kanë krijuar rreziqe për integritetin e shërbimeve. Sistemet aktuale nuk ofrojnë mekanizma të mjaftueshëm për validimin automatik të të dhënave dhe verifikimin ndërinstitucional. Shumë procese kryhen ende në mënyrë manuale, duke përfshirë regjistrimin, kategorizimin dhe përpunimin e aplikimeve për pension. Kjo shkakton gabime, vonesa dhe ulje të efikasitetit për shkak të proceseve manuale dhe mungesës së integrimit të sistemeve.

Sistemi nuk siguron verifikim të mjaftueshëm të të dhënave me regjistrat e jashtëm, nuk mbështet në mënyrë të plotë gjurmimin e vendimeve të komisioneve dhe nuk ofron kontroll të automatizuar për llogaritë bankare të përfituesve para ekzekutimit të pagesave. Këto mangësi krijojnë rrezik për pagesa të pasakta, përfitime të dyfishta dhe mosrespektim të kërkesave ligjore.

Mangësitë në kontrollet e sistemit cënojnë sigurinë e informacionit dhe rrisin mundësinë e keqpërdorimeve të skemave pensionale. Dobësitë në menaxhimin e qasjes, mungesa e enkriptimit dhe e politikave për sigurinë e fjalëkalimeve ekspozojnë sistemin ndaj qasjes së paautorizuar dhe keqpërdorimit të të dhënave. Po ashtu, mungesa e regjistrimit të plotë të aktiviteteve kufizon monitorimin dhe auditimin e veprimeve, veçanërisht të përdoruesve me privilegje administrative. Në

fund, është konstatuar se mungesa e politikave të formalizuara për kopje rezervë, vazhdimësi të shërbimeve dhe rikuperim nga fatkeqësitë e dobëson ndjeshëm vazhdimësinë e funksionimit të sistemit. Edhe pse kopjet rezervë realizohen në mënyrë teknike, mungesa e një plani të dokumentuar dhe të testuar për rikthim nga fatkeqësitë e bën sistemin të varur nga zgjidhje infrastrukturore ekzistuese, pa garanci të plota për rikuperim të shpejtë dhe të sigurt në rast incidentesh.

Prandaj, duke qenë se MFPT filloi ta shihte si sfidë problemin e të dhënave për skemat pensionale jo të unisuara, në vitet 2024-2025 ka hartuar një projekt ideor për zhvillimin e një sistemi të ri financiar dhe që do të përfshinte unifikimin e të gjitha skemave pensionale dhe sociale që do të adresonte edhe çështjet e ngritura. Por ende është pjesë e punës së bashku me donatorin që do të financoj.

Prandaj, rreziqet e identifikuara më lartë, tregojnë që institucionet , të cilat administrojnë të dhënat dhe dokumentet për pensionet dhe ofrojnë shërbime përmes Sistemit të Integruar Informativ për skemat Pensionale, kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Lidhur me këtë, kemi dhënë gjithsej 23 rekomandime, nga të cilat 21 rekomandime për Ministrinë e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare, (3 prej tyre janë të përbashkëta me MF dhe AShAK) si dhe 2 rekomandime të veçanta për Agjencinë Shtetërore të Arkivit të Kosovës. Lista e rekomandimeve, është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e entiteteve të përfshira në auditim

Ministrinë e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe është zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e auditimit, ndërsa Ministria e Financave dhe Agjencia Shtetërore e Arkivit të Kosovës nuk ka kthyer përgjigje, ne inkurajojmë për zbatimin e rekomandimeve.

HYRJE

01

1. Hyrje

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që nga viti 2026 e ndarë në Ministrinë e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare, menaxhon dhe administron një numër të madh skemash financiare, sociale dhe të punësimit që kanë për qëllim mbështetjen ekonomike dhe sociale të qytetarëve.

Figura 1. Tri grupet kryesore të skemave që administrohen nga Ministria.



Auditimi i teknologjisë së informacionit lidhur me Sistemin e Integruar Informativ për skemat pensionale trajton vetëm kategorinë e Skemave pensionale.

Pensionet përbëjnë një ndër shtyllat kryesore të sistemit të mbrojtjes sociale në Republikën e Kosovës, pasi ato sigurojnë mirëqenie ekonomike, mbështetje sociale dhe dinjitet për qytetarët pas përfundimit të jetës aktive në punë, duke garantuar siguri dhe barazi për të gjitha kategoritë shoqërore.

Në Republikën e Kosovës funksionojnë 13 skema pensionale, ecila prej këtyre skemave synon të mbrojë një kategori të caktuar të popullsisë, në varësi të kontributit, gjendjes shëndetësore apo statusit profesional.

Prandaj, për këtë kategori Republika e Kosovës ndan çdo vit buxhet shtetëror në një vlerë mbi 400 milionë euro, të cilat menaxhohen nga sistemet e informacionit SII dhe format e zhvilluara në Microsoft Access. Sipas të dhënave nga këto sisteme, nga gjithsej 13 skema pensionale që menaxhohen prej tyre, skemat me numrin më të lartë të pensionistëve dhe buxhetin më të lartë janë:

- Mbi 162 mijë pensionistë që marrin pensionin bazë me buxhet rreth 200 milionë euro.
- Mbi 47 mijë pensionistë që marrin pensionin Kontribut pagues me buxhet rreth 130 milionë.

Dhe skemat me nivelin më të lartë të ndjeshmërisë sociale:

- Pensioni për Personat me Aftësi të Kufizuara – PPAK;
- Kompensimi për të Verbërit dhe
- Kompensimi për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët.

Sistemi i pensioneve në Kosovë përbën një ndër mekanizmat më të rëndësishëm të mbrojtjes sociale dhe sigurisë ekonomike për qytetarët në moshë të shtyrë, personat me aftësi të veçanta dhe kategori të tjera të mbrojtura.

Menaxhimi i 3 skemave pensionale bëhet nga një ueb aplikacion, ndërsa për 10 skemat tjera ata kanë zhvilluar forma tabelare që ruajnë dhe menaxhojnë të dhënat nëpërmjet MS Access, të cilat janë të ruajtuara në baza të të dhënave në SQL Server.

Tabela 1. Kategoritë e skemave pensionale që u ofrohen grupeve të caktuara të shoqërisë, në formë të digjitalizuar.

Nr.	Lloji i pensionit	Lloji i teknologjisë
1.	Pensioni Bazë	net[7]
2.	Pensioni Kontribut pagues	
3.	Pensioni për Personat me Aftësi të Kufizuar	
4.	Pensioni Parcial Kontributiv	MS Access (të lidhura me SQL Server)
5.	Pensioni Kontributiv për Botën e Jashtme	
6.	Pensioni Familjar	
7.	Pensioni Invalidor i Punës	
8.	Pensionet Trepça	
9.	Kompensimi për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët	
10.	Kompensimi për të Verbërit	
11.	Kompensimi për Punëtorët e Arsimit Shqip	
12.	Pensionet e FSK	
13.	Pensionet e TMK	

Shuma e përkrahjes financiare që menaxhohet nga sistemet e skemave pensionale për të gjitha 13 kategoritë pensionale për vitin 2024 ishte 428,041,852 euro.

Në vijim është paraqitur procesi për përfitimin e skemave pensionale:

7 .net - Platformë për zhvillimin e aplikacioneve e krijuar nga Microsoft.

Figura 2. Procesi për përfitimin e pensionit

Informimi / Para-aplikimi:

Zyrtari i pensioneve ofron ndihmë dhe informata për aplikantët, duke dorëzuar fletën e informacionit dhe duke udhëzuar për sigurimin e dokumenteve të nevojshme.

Legjislacioni / Baza ligjore:

Zbatohen Ligji Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe udhëzimet administrative përkatëse.

Aplikimi / Regjistrimi:

Aplikanti plotëson dhe nënshkruan formularin përkatës; zyrtari shqyrton dokumentet dhe regjistron kërkesën në sistem.

Verifikimi / Aprovimi:

Bëhet kontrolli i dokumenteve, vlerësimi i plotësisë dhe konfirmimi i kritereve ligjore për përfitim.

Kategorizimi / Përfituesit:

Përcaktimi i kategorisë së përfituesit bëhet sipas strukturave kualifikuese dhe stazhit të kontributeve.

Vendimi / Përfituesit:

Nxjerrja e vendimit për njohjen ose refuzimin e kërkesës, i cili dërgohet palës dhe institucioneve përkatëse.

Kalkulimi / Procesimi i Pagesave:

IT realizon përllogaritjen mujore dhe krahasimin me skemat tjera, më pas procesohen pagesat mujore përmes sistemit të MFPT.

Procesi Ankimor / Ankesat:

Aplikanti mund të parashtrojë ankesë në organin e shkallës së dytë; ankesa shqyrtohet dhe merret vendimi përfundimtar.

Monitorimi / Kontrolla:

Monitorimi bëhet çdo muaj dhe çdo 6 muaj duke krahasuar të dhënat me ARC dhe duke raportuar nga Divizioni për Kontroll dhe Monitorim.

Sistemi përdoret nga shtatë qendra rajonale dhe 38 zyra komunale pensionale. Çdo përdorues ka llogari, ndërsa qasja dhe privilegjet caktohen sipas rolit institucional.

Mirëmbajtja dhe administrimi i sistemeve të decentralizuara për secilën skemë pensionale kryhen nga ekipi i brendshëm teknik i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ), që në vitet e fundit të Qeverisë ishte pjesë e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), që përfshin administratorin e bazës së të dhënave dhe zhvilluesin e aplikacioneve, në bashkëpunim me menaxhmentin.

OBJEKTIVI FUSHAT

02

2. Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektiv i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale dhe Aplikacionet përkatëse, funksionojnë në mënyrë efektive për administrimin e skemave pensionale, duke siguruar të dhëna të sakta, me shërbime të digjitalizuara në kohë reale për qytetarët.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për MFPT-në, përkatësisht MPFVLÇ-në, dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e procesit të pensioneve, në mënyrë që të përmirësojnë sistemin e informacionit lidhur me zhvillimin e procesit të skemave pensionale dhe kontrollet e aplikacionit.

Tabela 2: Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Zhvillimi dhe Blerja	Zhvillimi dhe menaxhimi i kërkesave
2. Kontrollet e Aplikacionit	1. Kontrollet e hyrjes
	Kontrollet e përpunimit
	Kontrollet e të dhënave dalëse
	Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

Fushëveprimi i këtij auditimi është MFPT dhe pas ndarjes në ministri të veçantë edhe MPFVLÇ, Departamenti i Pensioneve, në kuadër të këtij Departamenti përfshihen edhe zyrat regjionale që dy prej tyre janë pjesë e fushëveprimit Prishtina dhe Prizreni si dhe Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative në MFPT dhe MPFVLÇ. Gjithashtu, në fushëveprim është përfshirë edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për rolin e saj në ruajtjen dhe inventarizimin e dosjeve të punëtorëve në Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë, ku procesi i

privatizimit të tyre është menaxhuar nga kjo Agjenci, si dhe Agjencia për Arkivin Shtetëror të Kosovës për rolin e tij në procesin e dokumenteve të arkivuara.

Qëllimi i këtij auditimit është vlerësimi i zhvillimit dhe kontrolleve të aplikacionit për sistemin e teknologjisë së informacionit "Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale", menaxhimi i sistemit për skemat pensionale, me fokus në sigurinë e të dhënave dhe efikasitetin e proceseve të administrimit dhe trajtimit të të dhënave për skemat pensionale. Auditimi mbulon periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2026, si dhe të dhënat e kontratave për zhvillimin e sistemit të pensioneve në vitin 2008 dhe të dhënat e kontratës së vitit 2017 në emër të avancimit të sistemit.

03

GIEFUEIT DIHIMIT

3. Gjetjet e auditimit

Për menaxhimin e të dhënave të përfituesve të skemave pensionale, Ministria ka zhvilluar forma elektronike për të mbështetur proceset operacionale dhe administrative të të gjitha skemave pensionale në nivel vendi.

Megjithatë, menaxhimi i gjithsej 13 skemave pensionale, nuk është i unifikuar për shkak të mungesës së një sistemi të centralizuar për sinkronizimin e të dhënave, i cili në kohën kur u zhvillua (viti 2008) kishte vetëm 3 skema. Pastaj, pas përfundimit të kontratës për zhvillimin e sistemit, ata kishin zhvilluar ndaras edhe 10 skema të tjera të cilat nuk arritën të i integrojnë në të njëjtin sistem, në mungesë të një kontrate aktive dhe mundësive teknike që ofronte sistemi. Për më tepër, mungesa e digjitalizimit të të dhënave shkakton vonesa në trajtimin e kërkesave dhe përfitimin e pensioneve, ndërsa mungesa e kodit burimor dhe kufizimet e sistemit ekzistues kanë shtyrë MFPT-në të planifikojë një sistem të ri të unifikuar për të gjitha skemat pensionale. Gjetjet e dalura nga ky auditim ndërlidhen me zhvillimin dhe blerjen, dhe kontrollet e aplikacionit. Gjetjet janë të strukturuara sipas fushave dhe çështjeve të auditimit.

Figura 3. Struktura e çështjeve të auditimit të sistemit të tatimit në pronë

Zhvillimi dhe Blerja

- Mos implementimi i plotë i moduleve të parapara në kontratë për zhvillimin e SII
- Migrimi i paplotë i të dhënave dhe mungesa e një baze të të dhënave të centralizuar
- Fragmentim i sistemeve për skemat pensionale
- Mungesa e kodit burimor dhe rreziku për vazhdimësinë e sistemit
- Menaxhimi dhe qasja joefikase ndërinstitucionale në të dhënat e arkivuara për pensionet kontributpaguese

Kontrollet e aplikacionit

- Mungesë e validimit të të dhënave hyrëse në sistemin e Pensioneve
- Mungesë e kontrollit efektiv për regjistrimin e konfirmimit 6-mujor të pensionit
- Mungesë e verifikimit të automatizuar ndërmjet skemave pensionale
- Dobësi në trajtimin e aplikimeve në platformën e-Kosova
- Data e aplikimit gjatë përpunimit të të dhënave ruhet në formë manuale
- Mungesë e mekanizmave për verifikimin e përfitimit të pensioneve nga shtete të tjera
- Mungesë e evidencës elektronike për vendimmarrjen e komisioneve të pensioneve
- Mungesë e verifikimit paraprak në kontrollet dalëse për statusin e llogarive bankare
- Mospërputhje me praktikat e sigurisë së informacionit në menaxhimin e fjalëkalimeve
- Mangësi në gjurmueshmërinë e aktiviteteve në sisteme dhe në bazën e të dhënave
- Mungesa e planit për backup, vazhdimësi të biznesit dhe rikthim nga fatkeqësitë

Pjesa e parë e paraqitur në kapitull mbulon çështjet e identifikuara e që kanë nevojë për përmirësim që lidhen me zhvillimin e sistemit dhe nevojën e digjitalizimit të procesit.

Pjesa e dytë që është paraqitur mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me kontrollet e hyrjes, kontrollet e përpunimit, kontrollet e të dhënave dalëse dhe kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

3.1. Blerja dhe Zhvillimi

Zhvillimi, blerja dhe kontraktimi i jashtëm, sigurojnë se menaxhimi i kërkesave, analizimi dhe vendosja e prioriteteteve, mbështesin në vazhdimësi plotësimin e nevojave të përdoruesve në mënyrë optimale për zhvillimin e shërbimeve në Sistemin e Integruar Informativ për skemat pensionale.[8]

Figura 4. Blerja dhe Zhvillimi



1. Mos implementimi i plotë i moduleve të parapara në kontratë për zhvillimin e SII

Ministria analizon, prioritizon dhe menaxhon kërkesat e zhvillimit të sistemit që të sigurojë se nevojat e Ministrisë për digjitalizimin e procesit për ofrimin e skemave pensionale janë plotësuar në mënyrë efektive dhe optimale.[9]

Në planin ideor për zhvillimin e Sistemit të Integruar Informativ - SII dhe me kontratën e vitit 2008 për zhvillim të këtij sistemi ishin paraparë disa module (Invalidët e Luftës dhe të Afërmit e tyre; Pensionet Bazë; Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuara; Shërbimet Sociale; Ndihmat Sociale; Lista e Punëkërkuesve). Ndërsa, janë implementuar vetëm dy module të planifikuara (Pensionet Bazë dhe Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuara), poashtu është zhvilluar një modul

8 Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm.
9 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Zhvillimi dhe Blerja.

i paparaparë për pensionet kontribut-paguese, i cili në këtë formë vazhdon të përdoret edhe sot.

Edhe përkundër angazhimit të një Operatori Ekonomik për të analizuar kërkesat dhe përgatitur një plan ideor me nevojat dhe kërkesat e Ministrisë (në atë kohë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - MPMS) kërkesat nuk janë menaxhuar dhe prioritarizuar, dhe pastaj nuk janë zbatuar në përputhje me kontratën, duke rezultuar në një sistem që nuk e mbulon në mënyrë të plotë digjitalizimin e skemave pensionale sipas objektivit fillestar.

Për më tepër në vitin 2017 MPMS ka kontraktuar edhe një operator ekonomik për të zhvilluar një sistem krejtësisht të ri, por me titull të kontratës "Avansimi i sistemit të integruar (sistemet elektronike të menaxhimit të të dhënave për DPSF dhe DFIDL). Përmes kësaj kontrate Ministria arrinë të mbulojë nevojën që kishte lënë si pikë të pazbatuar në kontratën paraprake, lidhur me modulin Invalidët e Luftës dhe të Afërmit e tyre" që ishte paraparë të zhvillohej në kontratën e vitit 2008 dhe mungonte në SII. Shpenzimet për kontratën e vitit 2008 ishin në vlerë të 333,499 euro dhe për zhvillimin e ri me kontratën e vitit 2017, në vlerë të 64,989 euro, si dhe 8,950 euro shpenzime të tjera për kontratën për konceptimin e planit ideor dhe mbikëqyrjen e kontratës së zhvillimit të vitit 2008.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës ishte angazhuar një Operator Ekonomik dhe gjithashtu në një paragraf të kontratës një pjesë e përgjegjësisë së mbikëqyrjes për zbatimin e kontratës në aspektin profesional të TI-së i është lënë zyrtarëve të TI-së së Ministrisë (MPMS). Prandaj, si pasojë e mos definimit të qartë të përgjegjësve për mbikëqyrje mes OE dhe Zyrtarëve të TI-së lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, vërejmë edhe mungesën e dokumentacionit të plotë të raporteve të pranimit, duke qenë se asnjë nga këta s'kishte realizuar këtë përgjegjësi.

Mungesa e mbikëqyrjes dhe kontrollit efektiv mbi realizimin e moduleve ka shkaktuar devijim nga specifikimet kontraktuale. Prandaj, procesi i digjitalizimit mbetet i pjesshëm, duke krijuar sisteme të fragmentuara dhe duke mos siguruar mbulim të plotë të skemave pensionale.

2. Migrimi i paplotë i të dhënave dhe mungesa e një baze të të dhënave të centralizuar

Ministria analizon, prioritizon dhe menaxhon kërkesat e zhvillimit të sistemit që të sigurojë se nevojat e Ministrisë për digjitalizimin e procesit për ofrimin e skemave pensionale janë plotësuar në mënyrë efektive dhe optimale. [10]

Kontrata për zhvillimin e sistemit SII në vitin 2008 parashihte migrimin e mbi 1 milion të dhënave në një databazë qendrore me qëllim centralizimin dhe menaxhimin unik të informacionit. Në praktikë, jo të gjitha të dhënat janë migruar; një pjesë e konsiderueshme vazhdon të mbahet në libra amë dhe dokumente fizike, si dhe në një sistem të zhvilluar para vitit 1999-M4[11] që nuk ka asnjë ndërlidhje me sistemin aktual për pensionet kontributpaguese. Qasjet në sistemin M4 janë të kufizuara vetëm për numër të kufizuar të zyrtarëve në regjione, por edhe të dhënat nuk janë mjaftueshëm të kompletuara në këtë sistem (M4), prandaj shërbejnë edhe dokumentet fizike, të cilat tani janë shumë të vjetërsuara pasi që kanë filluar të dëmtohen faqet e librit gjatë përdorimit të shpeshtë, si dhe koha e gjatë ka ndikuar që të fshihen shkronjat.

Kjo gjendje e të dhënave është si shkak i planifikimit të pamjaftueshëm lidhur me specifikat për migrimin dhe mungesa e mbikëqyrjes së realizimit të kontratës. Po ashtu, nuk ka raporte për analiza të gjendjes së dokumentacionit (i cili për dëshmi të plotësimit të kritereve për pensionet përdoret në vazhdimësi në zyrat e pensioneve) dhe nuk janë ndërmarrë veprime për përmirësimin e gjendjes. Në vitin 2023, MFPT ka dërguar për aprovim projektin për zhvillimin e arkivës elektronike në AShI, por ata nuk e aprovuan dhe e orientuan të përshtatin përdorimin e sistemit të arkivës që ka zhvilluar AShI. Por për këtë duhet vet Ministria të siguroj resurset për skanimin e dokumenteve, të cilat ende nuk janë siguruar.

Si rezultat i migrimit jo të plotë të të dhënave dhe përdorimit të dokumentacionit fizik të vjetërsuar e sistemeve të pa ndërlidhura, procesi i verifikimit dhe administrimit të pensioneve bëhet më i ngadalshëm dhe më pak efikas. Kjo rrit rrezikun e

10 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Zhvillimi dhe Blerja.

11 Sistemi i përdorur para vitit 1999 për menaxhimin e dosjeve të personelit dhe stazhit të tyre të punës.

pasaktësisë ose humbjes së të dhënave, shkakton vonesa në trajtimin e kërkesave dhe mund të ndikojë në realizimin e të drejtës për pension kontributpagues. Në raste të mungesës së dokumentacionit, qytetarët mund të mbesin pa përfitim, veçanërisht për kriterin e 15 viteve kontribut para vitit 1999, ku edhe një muaj përvojë pune mund të jetë vendimtar në përfitimin apo mos përfitimin e pensionit kontribut pagues.

3. Fragmentim i sistemeve për skemat pensionale

Ministria analizon, prioritarizon dhe menaxhon kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive. [12]

Ministria aktualisht menaxhon 13 skema pensionale, por vetëm tri prej tyre janë të integruara në sistemin e zhvilluar në vitin 2008. Skemat e tjera janë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga zyrtarët e TI-së në Microsoft Access, pa u përfshirë në SII.

Zyrtarët e TI-së pa pasur përgjegjësi të caktuara për zhvillim në mënyrë të pavarur kanë zhvilluar kërkesat e menaxhmentit për skemat e reja në Microsoft Access, edhe pse Ministria nuk ka poseduar kontrolle të brendshme të TI-së për mbikëqyrje, lidhur me zhvillim. Në vitin 2015 ata kanë raportuar udhëheqësin e tyre se kanë zhvilluar 4 skema në Microsoft Access. Deri në vitin 2018 ata kanë zhvilluar 10 skema, që poashtu në këtë vit ata kanë njoftuar dhe raportuar edhe tek menaxhmenti i lartë i insitucionit për gjendjen e të dhënave dhe sistemeve, por që përkundër kësaj s'është ndërmarr ndonjë veprim. Mirëpo, pas ndryshimeve strukturore të Ministrisë dhe Qeverisë (bashkimit të dy ministrive) struktura e re brenda MFPT-së është njoftuar në vitin 2023 me situatën, dhe të cilët kanë filluar të ndërmarrin veprime në vitin 2024 dhe 2025 për krijimin e një sistemi të ri të integruar për të gjitha skemat pensionale.

Zhvillimi i skemave pensionale jashtë sistemit qendror SII dhe pa kontrolle të mjaftueshme të brendshme të TI-së ka krijuar fragmentim të të dhënave dhe proceseve, duke rritur rrezikun për mospërputhje, gabime në përpunimin e të

12 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Zhvillimi dhe Blerja.

dhënave për përfitimin e pensioneve dhe rrezik të lartë të integritetit të informacionit. Përdorimi i databazave të veçanta në Microsoft Access ka kufizuar monitorimin e centralizuar, ka vështirësuar mirëmbajtjen afatgjatë të sistemeve dhe ka rritur varësinë nga individë të caktuar. Për më tepër, mosveprimi i menaxhmentit ndaj njoftimeve të vazhdueshme nga stafi i TI-së ka vonuar modernizimin e sistemit, duke ndikuar në efikasitetin operacional dhe duke krijuar sfida shtesë për integrimin dhe standardizimin e plotë të skemave pensionale, të cilat përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve vjetore buxhetore.

Ndërsa zyrtarët e ministrisë zhvillimin e skemave në MS Access e arsyetuan pa kosto kontraktimi dhe të pa kushtueshëm në krahasim me zhvillimin e sistemit SII në vitin 2008. Por, nga ajo që u prezantua, ne vërejmë që ka mungesë të planifikimit strategjik për zgjerimin e sistemit ekzistues dhe mungesë e analizës së nevojave për zhvillimet e reja. Një komunikim, raportim dhe kontrolle të brendshme jo të mjaftueshme mes stafit të TI-së dhe atij menaxherial lidhur me zhvillimin e sistemit.

4. Mungesa e kodit burimor dhe rreziku për vazhdimësinë e sistemit

Ministria analizon, prioritarizon dhe menaxhon kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive, duke përfshirë definimin e pronësisë së sistemit dhe mundësinë e avancimit/zgjerushmërisë. [13]

Në kontratën e lidhur në vitin 2008 për zhvillimin e Sistemit Informativ për Integrim (SII) nga MPMS nuk është paraparë obligimi për dorëzimin e kodit burimor të sistemit tek Ministria. Pas përfundimit të kësaj kontrate, Ministria nuk ka lidhur asnjë kontratë tjetër për mirëmbajtjen, përditësimin apo avancimin e sistemit. Megjithatë, sistemi ka vazhduar të përdoret nga Ministria deri më sot dhe mbetet ende në funksion, pa ndryshime teknike që nga implementimi fillestar.

Lidhur me posedimin e kodit burimor, nga intervistat e zhvilluara me zyrtarët përgjegjës të Ministrisë është konfirmuar se Ministria nuk e posedon kodin burimor të sistemit. Kjo nënkupton se institucioni nuk ka kontroll të plotë mbi sistemin dhe

13 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Zhvillimi dhe Blerja.

është i kufizuar në mundësinë për të ndërhyrë në zhvillimin ose përshtatjen e tij sipas nevojave aktuale.

Për më tepër, sipas të dhënave në regjistrin e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), kompania që ka zhvilluar sistemin figuron si joaktive, duke e vështirësuar edhe më tej mundësinë e sigurimit të kodit burimor ose të mbështetjes teknike nga zhvilluesi fillestar.

Shkak për këtë situatë është specifikimi i pamjaftueshëm kontraktual dhe mungesa e analizës së rreziqeve afatgjata teknike, para dhe gjatë zhvillimit të sistemit.

Mungesa e posedimit të kodit burimor dhe e marrëveshjeve për mirëmbajtje ose avancim e ekspozon Ministrinë ndaj rrezikut të varësisë së plotë nga zhvilluesi fillestar, i cili në listën e regjistrimit të bizneseve figuron pasiv që nga viti 2022, duke kufizuar mundësinë për ndërhyrje teknike, korrigjim të gabimeve dhe përshtatje të sistemit me kërkesat e reja funksionale dhe ligjore. Si rezultat, varësia e lartë nga operatori ekonomik i cili nuk është më aktiv, kufizon mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejmë, si dhe, rrezikon vazhdimësinë e shërbimeve.

5. Menaxhimi dhe qasja joefikase ndërinstitucionale në të dhënat e arkivuara për pensionet kontributpaguese

Të dhënat nga AShAK për pensionet duhet të sigurojnë që digjitalizimi i procesit për ofrimin e skemave pensionale është plotësuar në mënyrë efektive dhe optimale. [14]

Menaxhimi dhe qasja në të dhënat për pensionet kontribut pagues nuk është realizuar në mënyrë të plotë dhe efikase ndërinstitucionale. Një pjesë e dokumentacionit mbi kontributet pensionale vazhdon të ruhet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa sipas legjislacionit për arkivat, dokumentacioni më i vjetër se 30 vjet duhet të transferohet në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Të gjitha regjionet kanë transferuar materialin arkivor në AShAK, përveç regjioni i Prishtinës dhe Gjilanit të cilët marrëveshjet mes dy institucioneve i kanë nënshkruar, mirëpo

14 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Zhvillimi dhe Blerja.

transferimi i arkivave nuk është përfunduar për shkak të mungesës së hapësirës për ruajtje në Arkivin Shtetëror.

Për më tepër, edhe pse Arkivi Shtetëror posedon sistem elektronik për menaxhimin e dokumenteve, procesi i digjitalizimit të plotë të materialeve arkivore, veçanërisht dosjeve të ish-ndërmarrjeve shoqërore, nuk është përfunduar. Si rezultat, pensionistët që aplikojnë për pension kontribut pagues detyrohen të paraqesin kërkesë në formë fizike përmes zyrave postare dhe të paguajnë për këtë shërbim për të siguruar nga arkiva dokumentet që dëshmojnë periudhën e kontributit. Kjo e bën më të ngadaltë procesin e sigurimit të dëshmive të nevojshme për pensionet, është më vështirë i qasshëm dhe me kosto shtesë për qytetarët.

- Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare ka ndikuar në mosrealizimin e digjitalizimit të plotë të materialeve arkivore, veçanërisht të dosjeve të ish-ndërmarrjeve shoqërore, pavarësisht ekzistimit të sistemit elektronik për menaxhimin e tyre.
- Mungesa e koordinimit dhe planifikimit të përbashkët ndërinstitucional ndërmjet institucioneve përgjegjëse ka vonuar krijimin e një mekanizmi efikas për transferimin, përpunimin dhe qasjen elektronike në të dhënat e nevojshme për verifikimin e kontributeve pensionale.
- Mungesa e qasjes elektronike në dokumentacionin e pensioneve kontribut pagues i ekspozon pensionistët ndaj barrës së panevojshme financiare dhe administrative, pasi ata detyrohen të paguajnë për çdo kërkesë fizike për sigurimin e dëshmive të kontributeve.

Si rrjedhojë, qytetarët, veçanërisht personat e moshuar, përballen me shpenzime shtesë, pritje të gjata dhe procedura, duke rritur vështirësitë në realizimin e të drejtës së tyre për pension dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre ekonomike.

3.2. Kontrollet e aplikacionit

Kontrollet e aplikacionit janë: kontrolli mbi funksionin e hyrjes, të përpunimit, të daljes dhe sigurisë. Ato përfshijnë metoda për të siguruar që: vetëm të dhëna të plota, të sakta, të vlefshme dhe të besueshme vendosen dhe azhurnohen në një sistem të informacionit, përpunimi realizon detyrën e saktë dhe rezultati i përpunimit plotëson pritjet dhe të dhënat ruhen.[15]

Figura 5. Kontrollet e aplikacionit



6. Mungesë e validimit të të dhënave hyrëse në sistemin e Pensioneve

Rregullat e vlefshmërisë në sistemin e pensioneve duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së tejkalimit të kontrolleve thelbësorë të hyrjes; si dhe ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit. [16]

15 Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Kontrollet e aplikacionit.
16 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

SII dhe skemat tjera të zhvilluara në Microsoft Access nuk kanë ndërlidhje direkte me sistemin e ARC-së për validimin e të dhënave gjatë regjistrimit të pensionistit. Në mënyrë manuale regjistrojnë të dhënat personale të qytetarit gjatë regjistrimit të aplikimit në sistem.

Gjithashtu, për pranimin e statusit jetësor në SII dhe skemat tjera bëhet një sinkronizim manual (përmes batch[17] file) në kohë jo reale me të dhënat nga ARC që e realizon administratori i bazës së të dhënave para ekzekutimit të pagesave.

Mirëpo, ky veprim pason me veprime të tjera manuale për personat, të cilët kanë vdekur në muajin e ekzekutimit të pensionit, pasi që statusi i vdekur i ndalon ekzekutimin e pagesës edhe për muajin e fundit që i takon. Prandaj, administratori i bazës së të dhënave detyrohet që në mënyrë manuale të i ndryshoj statusin nga "I vdekur" në "I gjallë" për të ekzekutuar pagesën dhe pastaj për të vendosur përsëri statusin "I vdekur".

Sistemi SII dhe skemat në Microsoft Access për regjistrimin e të dhënave bankare nuk e mundësojnë verifikimin-validimin e tyre përmes ndërlidhjeve gjatë regjistrimit të të dhënave bankare të pensionistit.

Prandaj, vërejmë që për regjistrimin e pensionistëve, validimi i identitetit, statusit jetësor dhe të dhënave bankare nuk bëhet automatikisht nga sistemi, por mbështetet në regjistrim manual nga zyrtari për regjistrim dhe ekziston kontroll kompensues nga zyrtari për vendosje në pagesë, i cili i kontrollon edhe njëherë të dhënat para vendosjes për pagesë.

Shkaku i mungesës së validimit të të dhënave është pa mundësia teknike pasi që koha kur është zhvilluar sistemi (viti 2008) e në vazhdim sistemi i ARC-së ka pasur ndryshime, ndërsa sistemi i pensioneve është zhvilluar njëherë dhe ka mbetur në atë formë pa mundësi ndërhyrje dhe avancimi, prandaj e vetmja mënyrë komunikimi është gjendur ajo përmes shkëmbimit të fajllave manual dhe kontrollit manual nga administratorët e TI-së që e bëjnë në baza mujore sinkronizimin e të dhënave. Po ashtu, për të dhënat bankare në sistemin SII është vendosur një kufizim në

17 Skedar që përmban një seri komandash të ekzekutuara automatikisht nga sistemi operativ.

karaktere dhe realizohet krahasim manual brenda sistemit por nuk identifikon saktësinë e numrit bankar në mungesë të një ndërlidhje. Po ashtu edhe zhvillimi i skemave në Microsoft Access ka bërë të pamundur krijimin e ndërlidhjeve direkte (me API [18]) për regjistrimin e të dhënave me ndërlidhje. Mungesën e ndërlidhjes e arsyetojnë me kohën e zhvillimit dhe pa mundësisë së përditësimit në mungesë të mirëmbajtjes.

Si rezultat, rritet rreziku i regjistrimit të pasaktë të të dhënave, ekzekutimit të pagesave të gabuara, vonesave në procesimin e pensioneve. Për më tepër, ndërhyrjet manuale në statusin e përfituesve gjatë ekzekutimit të pagesave rrisin rrezikun e gabimeve njerëzore, duke ndikuar negativisht në integritetin, besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të menaxhimit të pensioneve.

7. Mungesë e kontrollit efektiv për regjistrimin e konfirmimit 6-mujor të pensionit

Rregullat e vlefshmërisë në sistemin e pensioneve duhet të jenë të mirë-hartuara, duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së tejkalimit të kontrolleve thelbësorë të hyrjes[19]; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit. [20]

Bazuar në obligimin ligjor në fuqi, pensionistët janë të detyruar të paraqiten çdo 6 muaj në zyrat përkatëse për konfirmim të statusit jetësor ("gjallë") dhe të rezidencës në Kosovë.

Gjatë ekzaminimeve në terren janë identifikuar raste kur përfituesit janë paraqitur për konfirmim 6-mujor, por zyrtari nuk e ka regjistruar lajmërimin në sistem, duke shkaktuar ndërprerje të padrejtë të pensionit.

18 API (Application Programming Interface) – grup rregullash dhe protokollesh që mundëson integrimin dhe ndërveprimin e sistemeve përmes shkëmbimit të automatizuar të të dhënave.
19 Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti 2023 dhe Aktgjykimi në rastin KO35/24 parashtrues Avokati i Popullit 2025;
20 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

Të cilat pas ankesave dhe dëshmive të ofruara nga pensionisti për lajmërim janë përmirësuar, por që për disa muaj pensionisti ka mbetur pa pension duke u detyruar të dëshmojë se ka bërë lajmërimin fillestar. Proces ky që për pensionistët është i lodhshëm dhe ka kosto të shtuar administrative.

Për shkak të obligimit ligjor që i detyron pensionistët të paraqiten fizikisht çdo 6 muaj për konfirmim të statusit jetësor dhe rezidencës, nuk është trajtuar mundësia e ndërlidhjeve automatike me sistemet relevante shtetërore (p.sh. ARC), i cili do të mundësonte verifikim shtesë të statusit jetësor dhe të sistemeve relevante për identifikimin e rezidencës përmes lëvizjeve të pensionistit. Shkak tjetër për mos evidentimin e pensionistëve të lajmëruar është edhe mungesa e kontrolleve sistemore të detyrueshme që sigurojnë regjistrimin e saktë dhe të plotë të këtij konfirmimi në sistem, apo ndonjë kontrolli tjetër që do ta siguronte eliminimin e gabimeve. Për më tepër, mungojnë mekanizmat e brendshëm të verifikimit dhe monitorimit të rasteve të papërfunduara, të cilat do të garantonin që çdo paraqitje fizike të reflektohet domosdoshmërisht në sistem.

Mungesa e regjistrimit të saktë dhe në kohë të konfirmimit të statusit jetësor mund të shkaktojë ndërprerje të padrejtë të pensioneve për përfituesit e paraqitur rregullisht, duke rezultuar në humbje të përkohshme të të ardhurave dhe rritje të barrës administrative. Gjithashtu, dobëson besueshmërinë e sistemit, rrit rrezikun e gabimeve dhe krijon pasiguri në trajtimin e të drejtave të pensionistëve.

8. Mungesë e verifikimit të automatizuar ndërmjet skemave pensionale

Rregullat e vlefshmërisë në sistemin e pensioneve duhet të jenë të mirë-hartuara, duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së tejkalimit të kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit. [21]

Gjatë regjistrimit të një qytetari në një skemë të re pensionale, zyrtari për të verifikuar nëse qytetari është tashmë përfitues i ndonjë skeme tjetër, duhet të kryejë kontroll manual duke hapur veçmas secilën formë në sistemet Microsoft

21 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

Access dhe SII. Kjo ndodh pasi mënyra e zhvillimit të sistemeve për skemat pensionale nuk mundëson verifikim automatik të përfituesve nga sistemi.

Për më tepër, në skemën për kompensimin e personave të verbër e cila është zhvilluar në Microsoft Access, zyrtarët detyrohen të bëjnë kërkesë për ndërhyrje nga zyrtarët e TI-së, për rastet e qytetarëve që nuk aplikojnë për herë të parë, pasi që nuk mund të ri-aplikojnë apo përditësojnë rastin në mungesë të numrit të dosjes së vjetër dhe nuk mund të bëhet kërkim me numër personal.

Shkaku i problemit të mos ndërlidhjes së skemave është mungesa e një baze të unifikuar të të dhënave për të gjitha skemat pensionale në një sistem qendror, si pasojë e zhvillimit të fragmentuar dhe planifikimit jo të mjaftueshëm të sistemeve për menaxhimin e pensioneve. Ndërsa sa i përket problemit të kompensimit për personat e verbër, nga zhvilluesit e skemës në Microsoft Access u arsyetua që kërkimi me numër të dosjes ishte kufizuar për të rritur kontrollin. Por ky kufizim jo funksional ishte bërë si pasojë e zhvillimit të formës në Microsoft Access që nuk lejon fleksibilitet për përshtatje me të gjitha kërkesat.

Mungesa e verifikimit automatik të përfituesve rrit rrezikun që një qytetar të regjistrohet gabimisht në më shumë se një skemë pensionale ose të mos identifikohen përfitimet ekzistuese, duke shkaktuar pagesa të padrejta, vonesa në përpunim dhe ngarkesë shtesë administrative për stafin. Po ashtu, kontrolli manual rrit mundësinë e gabimeve njerëzore dhe ndikon negativisht në saktësinë dhe besueshmërinë e sistemit të menaxhimit të pensioneve.

9. Dobësi në trajtimin e aplikimeve përmes platformës e-Kosova

Rregullat e vlefshmërisë janë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë

së kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit. [22]

Përveç formës fizike në zyrat e pensioneve, qytetarët për skemat pensionale për personat paraplegjik, tetraplegjik, personat me aftësi të kufizuara dhe kompensimin për personat e verbër mund të aplikojnë edhe në formë elektronike përmes platformës "e-Kosova". Të cilat aplikime shkarkohen nga e-Kosova në një dokument dhe pas shqyrtimit fillestar, regjistrohen në mënyrë manuale nga zyrtarët për pensione te forma përkatëse në sistemet e pensioneve.

Mirëpo, gjatë auditimit kemi vërejtur se aplikimet që janë pranuar përmes platformës e-Kosova kanë qenë aplikime jo të plota, të plotësuara pjesërisht apo edhe me gabime në plotësimin e të dhënave dhe ngarkimin gabim të dokumentit. Për të cilat aplikime na shpjeguan zyrtarët se duhet ti kontaktojnë edhe njëherë aplikuesit dhe ti kërkojnë të lajmërohen në zyrat e pensioneve për të plotësuar dhe kompletuar aplikimet.

Gjithashtu, gjatë auditimit kemi identifikuar që aplikimet për kompensimin për të verbrit përmes e-Kosova nuk janë shqyrtuar fare nga asnjë nivel i zyrtarëve. Pasi që zyrtarët përkatës që ishin pjesë e komisionit për shqyrtim edhe përkundër faktit që kishin kërkuar qasje nuk i ishte dhënë.

Për të analizuar shkakun për problemet lidhur me menaxhimin e skemave pensionale në e-Kosova ne takuam zyrtarë përgjegjës për menaxhimin e platformës e-Kosova në AShI të cilët na njoftuan me detajet: sa i përket formave të aplikimit ishte dizajni që kishte miratuar MPFVLÇ, përkatësisht MFPT, prandaj me kërkesën dhe aprovimin e tyre mund të bëhen edhe ndryshme. Ndërsa sa i përket ofrimit të qasjes ata me rastin e lansimit të skemave në platformë i kishin dhënë qasje personit kontaktues nga ana e MFPT, që pastaj do të duhej të vendoste qasjen te personat përgjegjës. Mirëpo, nuk kishin ndonjë procedurë të miratuar dhe që informonte institucionet fundore për qasjet në e-Kosova. Prandaj, si përfundim, mungesa e qasjes në e-Kosova ka ndodhur si pasojë e një komunikimi jo të plotë

22 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

mes MFPT dhe AShI-së pasi që nuk ishte përcjellur njoftimi për qasje tek MFPT, në mungesë të procedurës së definuar për qasje në platformën e-Kosova.

Mangësitë në dizajnin e formularëve elektronikë në e-Kosova të miratuar nga MFPT dhe mosdhënia e qasjeve të nevojshme për zyrtarët përgjegjës të MFPT-së, mund të shkaktojnë vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, rritje të ngarkesës administrative dhe trajtim joefikas të kërkesave të qytetarëve. Si rezultat, ekziston rreziku që përfituesit e skemave pensionale të mos i realizojnë të drejtat e tyre me kohë, duke ulur besimin e qytetarëve në shërbimet elektronike institucionale.

10. Mangësitë e sistemit të informacionit në përpunimin e të dhënave

Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur.[23] Duke u bazuar në legjislacionin dhe aktet tjera nën ligjore lidhur me skemat pensionale. [24]

Gjatë përpunimit të aplikimeve për pension, data e aplikimit nuk transferohet automatikisht nga faza fillestare e regjistrimit, por kërkohet të ri-shkruhet manualisht nga zyrtari në forma të ndara të zhvilluara në Microsoft Access. Po ashtu, procesi i ndryshimit të kategorisë së pensionit realizohet përmes komisioneve përkatëse, mirëpo vendimet e këtyre komisioneve ruhen vetëm në format Word dhe në formë fizike, pa u ngarkuar dhe regjistruar në sistem elektronik. Sistemi përmban vetëm të dhëna bazike si emrat e anëtarëve të komisionit, datën e komisionimit dhe statusin e aprovimit apo refuzimit, por jo dokumentacionin e plotë të vendimmarrjes. Prandaj, nga auditimi është konstatuar se proceset kryesore të menaxhimit të skemave pensionale nuk janë të integruara plotësisht në Sistemin Informativ për skemat pensionale (SII).

Kjo situatë ka ardhur si shkak i kufizimeve teknike të sistemit ekzistues, i cili është zhvilluar fillimisht vetëm për disa skema pensionale dhe nuk ka paraparë zgjerim

23 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e përpunimit.
24 Ligji Nr.08/L-248 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 04/L-131 Për Skemat Pensionale Të Financuara Nga Shteti; Udhëzim Administrativ Mfpt Nr. 03/2022; Udhëzimi Administrativ (Mpms) Nr. 09/2015; Rregullore (Mfpt) Nr. 01/2025; Rregullore (Qrk) Nr.23/2024;

apo integrim të plotë të proceseve tjera. Për këtë arsye, një pjesë e skemave pensionale dhe funksionaliteteve janë zhvilluar në forma të ndara në Microsoft Access, të cilat nuk ofrojnë module të integruara për transferim automatik të të dhënave dhe dokumentim elektronik të vendimeve të komisioneve. Gjithashtu, faktorët organizativë, përfshirë mungesën e qasjeve të komisioneve në sistem dhe angazhimin e përkohshëm të një pjese të stafit, kanë ndikuar në mosintegrimin e plotë të procesit të vendimmarrjes në sistemin informativ.

Mungesa e integrimit elektronik dhe regjistrimi manual i të dhënave rrisin rrezikun për mospërputhje dhe gabime në përpunimin e aplikimeve, humbje, dëmtim apo manipulim të dokumentacionit, si dhe cenojnë gjurmueshmërinë, transparencën dhe besueshmërinë e procesit të menaxhimit të pensioneve. Kjo situatë vështirëson mbikëqyrjen dhe auditimin e mëvonshëm të vendimeve, rrit rrezikun për trajtim jo të barabartë të aplikantëve dhe mund të shkaktojë dëmtim financiar si për aplikuesit ashtu edhe për shtetin.

11. Mungesë e mekanizmave për verifikimin e përfitimit të pensioneve nga shtete të tjera

Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur, duke siguruar që aplikuesi të paraqesë dëshmi se nuk është përfitues i pensionit nga ndonjë prej shteteve për të cilat Kosova nuk ka marrëveshje, në pajtim me legjislacionin dhe aktet tjera nënligjore lidhur me skemat pensionale. [25]

Gjatë procesit të përpunimit të të dhënave të aplikimit për pension kemi gjetur se nëse përfituesi merr pension në shtete të tjera në sistem nuk ka kriter për verifikimin. Për më tepër në procesin e aplikimit për pension, përveç dokumentacionit standard të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, nuk kërkohet nga aplikantët dorëzimi i një dëshmie që vërteton se nuk janë përfitues të pensionit nga ndonjë shtet tjetër, veçanërisht nga shtetet me të cilat Republika e Kosovës ka marrëveshje ndërkombëtare për koordinimin e skemave pensionale, e aq më pak

25 Ligji Nr.08/L-248 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 04/L-131 Për Skemat Pensionale Të Financuara Nga Shteti; Udhëzim Administrativ Mfpt Nr. 03/2022; Udhëzimi Administrativ (Mpms) Nr. 09/2015; Rregullore (Mfpt) Nr. 01/2025; Rregullore (Qrk) Nr.23/2024;

me ato që nuk ka marrëveshje edhe pse në kriterin për përfitimin e pensioneve në aktet nënligjore është e theksuar.

Mungesa e këtij kriteri është vërejtur si në aspektin procedural, ashtu sistemin elektronik, në dokumentacionin e aplikimit nuk është identifikuar kërkesë eksplicite për deklarim ose dëshmi mbi përfitimet pensionale jashtë Kosovës. Sistemi që mbështet administrimin e pensioneve nuk përmban kontrolle apo fusha të dedikuara për regjistrimin, verifikimin e këtij informacioni.

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak të pamundësisë për verifikimin sistemor të statusit të aplikantëve në raport me përfitimet pensionale jashtë Republikës së Kosovës. Ndërsa, për pensionin bazë të moshës ata e arsyetojnë uljen e rrezikut me verifikimin e rezidencës – lajmërimin çdo 6 muaj.

Si pasojë e mungesës së verifikimit efektiv, ekziston rreziku që persona të caktuar të përfitojnë pension nga skemat pensionale në Kosovë, ndërkohë që marrin pension edhe nga shtete të tjera, e që është në kundërshtim me kriteret ligjore. Kjo situatë rrit rrezikun e pagesave të padrejta dhe mund të shkaktojë humbje financiare për buxhetin publik.

12. Mungesë e verifikimit paraprak në kontrollet dalëse për statusin e llogarive bankare

Ministria duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.[26]

Sistemi i pensioneve për skemat e zhvilluara në Microsoft Access nuk verifikon llogaritë bankare të pensionistëve para se të ekzekutojë pagesat. Prandaj, në rastet kur llogaritë bankare nuk janë aktive apo nuk janë të sakta, pensioni i ekzekutuar

26 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse.

nuk arrin të pranohet nga qytetari derisa ai të ankohet dhe të sqarojë arsyen e kthimit të mjeteve dhe mospranimit të tyre.

Janë analizuar pagesat e ekzekutuara në Regjionin e Prizrenit për 6 muajt e fundit 2025 dhe janë testuar disa mostra, prej të cilave kemi vërejtur se sistemi ka lejuar ekzekutimin e pagesës në një llogari bankare të mbyllur. Mjetet janë kthyer nga banka pas ekzekutimit dhe qytetari nuk i ka pranuar mjetet derisa është ankuar dhe i është përmirësuar numri i llogarisë në mënyrë manuale.

Kjo ka ndodhur për shkak që sistemi i pensioneve nuk ka verifikim të saktë të llogarive në mënyrë automatike dhe të dhënat e llogarisë nuk janë të ndërlidhura me qytetarin përkatës, pasi që nuk ekzistojnë mekanizma për verifikimin automatik të llogarive bankare të përfituesve para ekzekutimit të pagesave. Për pasojë, çdo gabim ose llogari e mbyllur nuk identifikohet paraprakisht, duke detyruar zyrtarët të korrigjojnë manualisht të dhënat vetëm pas ankesës së qytetarit.

Si rezultat, qytetari e përfiton pensionin me vonesë dhe në rast se nuk paraqet ankesë, mund të mos e përfitojë fare.

13. Mospërputhje me praktikat e sigurisë së informacionit për menaxhimin e fjalëkalimeve

Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrolle efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për të siguruar autentifikimin, autorizimin dhe monitorimin e aksesit. [27]

Sistemi i Integruar Informativ (SII) nuk siguron kompleksitet të fjalëkalimeve. Gjatë punës në terren me zyrtarët e Departamentit të Pensioneve, në kuadër të Zyrave Rajonale në Prishtinë, është evidentuar se zyrtarët përdorin fjalëkalime të thjeshta dhe nuk janë të obliguar nga sistemi të i ndryshojnë fjalëkalimet.

27 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

Nga verifikimet e kryera me administratorët e bazës së të dhënave është vërejtur qartë se fjalëkalimet e përdorura janë të thjeshta, nuk zbatohej politikë për sigurinë e fjalëkalimit, dhe për më tepër ato nuk ishin edhe të enkriptuara, prandaj kanë nivel të pa mjaftueshëm sigurie.

Kjo gjendje ka ardhur si shkak i mungesës së zbatimit të një politike të qartë dhe të detyrueshme për menaxhimin dhe kompleksitetin e fjalëkalimeve për sistemin e Pensioneve, si dhe mungesës së mekanizmave teknikë për enkriptimin dhe detyrim të kompleksitetit të fjalëkalimit.. Po ashtu, mungon vetëdijesimi i zyrtarëve lidhur me rëndësinë e sigurisë së informacionit dhe përgjegjësinë individuale në përdorimin e kredencialeve personale.

Si rezultat i përdorimit të fjalëkalimeve të thjeshta dhe mungesës së mekanizmave mbrojtës siç është enkriptimi, rritet ndjeshëm rreziku për qasje të paautorizuar në sistem, keqpërdorim ose manipulim të të dhënave dhe humbje të integritetit të informacionit. Kjo situatë e vështirëson identifikimin e përgjegjësisë individuale për veprimet e kryera në sistem, pasi ekziston rreziku që lëndët mund të procesohen nga persona të ndryshëm nën të njëjtat kredenciale. Si pasojë, mund të krijohen parregullsi në trajtimin e lëndëve, vonesa në shërbime, cenim i besueshmërisë së proceseve institucionale, si dhe rrezik ligjor dhe administrativ për institucionin.

14. Mangësi në gjurmueshmërinë e aktiviteteve në sisteme dhe bazën e të dhënave

Për të dhënat në sistemet e informacionit duhet të ekzistojnë gjurmë auditimi që regjistrojnë ndryshimet (editimet), tejkalimet e kontrolleve dhe regjistrat e autorizimit për transaksionet kritike; këto gjurmë auditimi duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të monitoruar aktivitetet e pazakonta; gjurmët e auditimit duhet të mirëmbahen dhe mbrohen në mënyrë adekuate; si dhe çdo transaksioni duhet të i caktohet një numër identifikues unik dhe sekuencial. [28]

28 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

Organizatat duhet të sigurojnë gjurmueshmëri të aktiviteteve të administratorëve përmes log-eve dhe evidencave të kërkesave për mbështetje teknike.[29]

Në Sistemin e Integruar Informativ (SII) është zhvilluar vetëm ruajtja e gjurmëve për aktivitetet e përdoruesve të thjeshtë (zyrtarëve regjistrues, editues, miratues), mirëpo jo edhe atyre administratorë (zyrtarëve të TI-së për veprimet administruese të sistemit, duke përfshirë edhe administrimin e bazave të të dhënave).

Sistemet aktuale për menaxhimin e skemave pensionale në MPFVLÇ (SII, Microsoft Access dhe bazat e tyre të të dhënave) pamundësojnë që të monitorohen gjurmët e aktivitetit të llogarive administratorë, në rast të ndonjë ndryshimi në sistem apo ndryshim në bazën e të dhënave. Në sistemin SII ky funksionalitet nuk është zhvilluar nga kompania që e ka zhvilluar sistemin, edhe pse sipas kontratës ishte paraparë zhvillimi i këtij moduli dhe përgatitja e një log serveri për ruajtjen e ndarë të këtyre aktiviteteve. Me këtë rast këto aktivitete mbeten të paidentifikuara dhe nuk mund të përcaktohet se çfarë veprime dhe ndryshime realizohen në sistem dhe të dhëna nga qasjet me rolin administratorë. Prandaj nga gjurmët e analizuara ne vërejmë që ekzistojnë vetëm gjurmë të aktiviteteve të përdoruesve të thjeshtë por jo edhe atyre me privilegje administrimi.

Përveç kësaj, 10 skema të tjera që janë të zhvilluara në forma të Microsoft Access, nuk mundësojnë ruajtje të gjurmëve fare, prandaj gjurmët e aktiviteteve të përdoruesve nuk mund të identifikohen për asnjërën nga kategoritë e përdoruesve.

Por, çka është më e rëndësishme nuk ka gjurmë të aktiviteteve të përdoruesve për asnjë skemë me rolin administrator në bazën e të dhënave, në të cilën administratorët kanë qasje të plotë për administrim, regjistrim, editim dhe fshirje.

Mangësitë në zbatimin e kontratës kanë lënë pa zhvillim edhe modulin për ruajtjen e gjurmëve dhe log serverin e ndarë që në fillesat e para të zhvillimit të sistemit të pensioneve. Pastaj edhe zhvillimi në Microsoft Access ka kufizuar mundësinë e ruajtjes së gjurmueshmërisë.

29 ISO/IEC 27001 – kontrolli për menaxhimin e qasjeve dhe regjistrimin e aktiviteteve administrative.
COBIT – proceset DSS05 dhe DSS06 për menaxhimin e sigurisë dhe kontrollin e operacioneve të TI-së.

Mungesa e gjurmueshmërisë së aktiviteteve të administratorëve rrit rrezikun e ndryshimeve të paautorizuara në sistem dhe në bazën e të dhënave, pa mundësi identifikimi të personit përgjegjës. Kjo situatë dobëson kontrollin e brendshëm, zvogëlon llogaridhënien dhe e bën të pamundur hetimin efektiv në rast të incidenteve të sigurisë, manipulimit të të dhënave apo gabimeve sistemore. E për më tepër kur vete administratorët e sistemit janë edhe administrator të bazës së të dhënave dhe zhvillues të formave në Access, si dhe kanë qasje për ekzekutim në sistem sipas kërkesave të zyrtarëve dhe ekzekutojnë pagesat i përgatisin format në excel për pagesë për të i dërguar në Thesar, kjo mund të ndikojë në gabime të qëllimshme apo pa qëllimshme të zyrtarëve dhe mos identifikim të tyre.

15. Mungesa e planit për kopjen rezervë, vazhdimësi të biznesit dhe rikthim nga fatkeqësitë

Aplikacioni duhet të ketë një plan të dokumentuar për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, duke përfshirë mekanizma të sigurt të backup-it dhe rikuperimit, sipas domainit mbi PVB/PRF. Planet e sigurisë dhe rimëkëmbjes duhet të testohen rregullisht për të garantuar vijueshmërinë e biznesit dhe mbrojtjen e informacionit. [30]

Zyrtarët e TI-së në Departamentin e Pensioneve realizojnë kopje rezervë (backup) në baza të rregullta, por MFPT - MPFVLÇ nuk ka të hartuar një politikë për kopje rezervë dhe rikthim nga fatkeqësitë, prandaj nuk ka as edhe një plan për rikthimin e të dhënave dhe sistemit në rast të humbjes së të dhënave nga fatkeqësitë. Kopja rezervë e të dhënave të SII realizohet në mënyrë të automatizuar dhe ditore, në infrastrukturën qendrore ku është i vendosur edhe sistemi i pensioneve në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (AShI).

Prandaj edhe zgjidhjen për vazhdimësinë e biznesit dhe rikthim nga fatkeqësitë për sistemin e skemave pensionale e ndërlidhin me zgjidhjen që do të ofrojë AShI për të gjitha institucionet.

30 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

Shkakun e mungesës së planit e ndërlidhin me mungesën e zgjidhjes teknike. Edhe pse plani duhet të ekzistoj edhe për zgjidhjen ekzistuese për rikthimin e kopjes rezervë dhe kohën e ndërprerjes dhe funksionalizimit të sistemit.

Por në mungesë të zgjidhjes teknike ata nuk kanë hartuar edhe planin për rikthim nga fatkeqësia, pasi që Qendra për Rikthim nga Fatkeqësitë planifikohet të krijohet për të gjitha institucionet nga AShI.

Mungesa e një plani vazhdimësi të biznesit dhe rikthim nga fatkeqësitë e bën Sistemin e Integruar Informativ (SII) të ekspozuar ndaj ndërprerjeve kritike dhe humbjes së të dhënave. Në rast të ndonjë incidenti të papritur, si dështim i serverit, sulm kibernetik ose fatkeqësi natyrore, nuk ka një mekanizëm të dokumentuar dhe të testuar për rikthim të shpejtë të operimeve, duke rrezikuar funksionimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurinë e informacionit.

KONKLUZIONET

04

4. Konkluzionet

Auditimi ka konstatuar se Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale dhe aplikacionet përkatëse nuk funksionojnë plotësisht në mënyrë efektive për administrimin e skemave pensionale dhe nuk sigurojnë në tërësi të dhëna të sakta dhe shërbime të digjitalizuara në kohë reale për qytetarët. Sistemi i Integruar Informativ (SII) për skemat pensionale luan një rol kyç në administrimin e një buxheti të konsiderueshëm publik dhe në realizimin e të drejtave të qytetarëve për përfitime pensionale. Megjithatë, dobësitë e identifikuara në zhvillimin, menaxhimin dhe funksionimin e sistemit, mungesa e integrimit dhe digjitalizimit të plotë të të dhënave dhe proceseve, si dhe kontrollet e pamjaftueshme të aplikacionit dhe sigurisë, ndikojnë negativisht në integritetin e të dhënave dhe efikasitetin e proceseve. Si rezultat, është rritur rreziku i vonesave në trajtimin e aplikimeve, gabimeve në përfitime, trajtimit të pabarabartë të përfituesve dhe cenimit të të drejtave të qytetarëve.

Blerja dhe zhvillimi

Zhvillimi i Sistemit të Integruar Informativ (SII) nuk është realizuar në përputhje me objektivat dhe kërkesat fillestare, duke rezultuar në implementim të pjesshëm dhe zhvillim të fragmentuar të moduleve. Për shkak të mungesës së një strukture të qartë të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së kontratës, si dhe e përgjegjësive të mirë definuara, ka çuar në devijime nga specifikimet fillestare dhe në mungesë të mekanizmave efektivë korrigjues.

Po ashtu, mungesa e migrimit të plotë të të dhënave në një sistem të vetëm qendror dhe mos digjitalizimi i dokumentacionit kanë bërë që menaxhimi i të dhënave të mbetet i fragmentuar dhe joefikas, duke vështirësuar verifikimin e përvojës së punës së pensionerëve dhe duke ndikuar në realizimin e drejtë dhe me kohë të përfitimeve pensionale, për shkak të mungesës së realizimit të kontratës dhe mungesës së ndërlidhjeve ndërinstitucionale.

Ministria nuk ka siguruar një qasje të qëndrueshme për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve, për shkak që një pjesë e madhe e skemave janë zhvilluar në forma të Microsoft Access jashtë sistemit qendror dhe pa kontroll të duhur institucional. Për më tepër, mungesa e pronësisë mbi kodin burimor dhe varësia nga operatori ekonomik kanë kufizuar aftësinë për mirëmbajtje, zhvillim dhe përshtatje të sistemit sipas nevojave institucionale.

Gjithashtu, mungesat në digjitalizimin dhe menaxhimin e arkivave kanë ndikuar në qasjen joefikase në të dhëna, duke shkaktuar vonesa, kosto shtesë dhe vështirësi për pensionistët kontributpagues në realizimin e të drejtave të tyre, për shkak të mungesës së hapësirës dhe digjitalizimit të tyre.

Kontrollet e aplikacionit

Për shkak të mangësive në kontrollet e aplikacionit dhe në funksionalitetin e sistemeve aktuale kanë mangësi që kanë ndikuar ndjeshëm në saktësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, si dhe në efikasitetin e proceseve të administrimit të skemave pensionale. Sistemi nuk siguron validim automatik të të dhënave me regjistrat përkatës dhe mbështetet në kontrolle manuale, për shkak që të dhënat regjistrohen dhe përpunohen në mënyrë manuale, duke rritur rrezikun e gabimeve dhe vonesave në pagesa, që kanë ndikuar në ulje efikasiteti, shërbime të vonuara dhe jo cilësore për përfituesit e skemave.

Mungesa e integrimit ndërmjet sistemeve dhe zhvillimi i tyre i fragmentuar, për këtë shkak zyrtarët janë detyruar të kryejnë procese manuale dhe të varen nga ndërhyrje teknike edhe për raste rutinore, duke kufizuar efikasitetin dhe kontrollin e brendshëm. Proceset në platformën e-Kosova nuk janë zhvilluar në mënyrë efikase, për këtë shkak nuk garantojnë mbledhjen e saktë të të dhënave dhe trajtimin e plotë të aplikimeve.

Procesi i regjistrimit dhe kategorizimit të aplikimeve nuk është i automatizuar në mënyrë të mjaftueshme, për shkak që të dhënat regjistrohen manualisht në më shumë se një sistem dhe dokumentacioni nuk digjitalizohet, duke rrezikuar integritetin dhe konsistencën e të dhënave.

Dobësi të tjera përfshijnë mungesën e mekanizmave për verifikimin e përfitimeve nga shtetet e tjera, mungesën e gjurmueshmërisë së vendimeve të komisioneve, si dhe mungesën e verifikimit automatik të llogarive bankare, duke rritur rrezikun për pagesa të pasakta, përfitime të padrejta dhe moszbatim të plotë të kërkesave ligjore.

Në aspektin e sigurisë, përdorimi i fjalëkalimeve të pasigurta, për shkak të mungesës së mekanizmave të enkriptimit dhe politikave të kompleksitetit, si dhe mungesa e gjurmueshmërisë së aktiviteteve, veçanërisht atyre të llogarive administratorë, si dhe mos implementimi i log server-it, e ekspozojnë sistemin ndaj rrezikut të qasjes së paautorizuar, manipulimit të të dhënave dhe humbjes së integritetit të informacionit.

Gjithashtu, mungesa e politikave dhe procedurave të dokumentuara për backup, vazhdimësi biznesi dhe rikthim nga fatkeqësitë tregon për dobësi në menaxhimin e rrezikut dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë së operimit të sistemit.

REKOMANDIMET

05

5. Rekomandimet

Rekomandimet për Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare dhe Ministrinë e Financave, si dhe Agjencinë e Arkivit Shtetëror të Kosovës.

1. **Migrimi i të dhënave në një bazë të dhënave të centralizuar.** Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ) duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar veprimi për përfundimin e migrimit të të dhënave historike në databazën qendrore të pensioneve përmes digjitalizimit të dokumentacionit dhe ndërlidhjes me sistemin e Agjencisë së Arkivit Shtetëror për sigurimin e të dhënave të pensioneve kontributpaguese.

   1.1. Gjithashtu, duhet të forcojë mekanizmat e mbikëqyrjes së projekteve të teknologjisë informative për të siguruar që kërkesat kontraktuale të realizohen plotësisht.

2. **Implementimi i plotë i moduleve të parapara për zhvillimin e SII.** MPFVLÇ duhet të sigurojë një qasje të strukturuar dhe të centralizuar për menaxhimin e projekteve të TI-së, duke vendosur një mekanizëm të qartë për menaxhiminin e kërkesave sipas prioriteteve dhe dokumentimit të plotë të procesit të pranimit dhe punëve të kryera.

3. **Unifikimi i sistemit për skemat pensionale.** MPFVLÇ në bashkëpunim me MF-në duhet të vazhdojë zhvillimin e sistemit qendror për integrimin e të gjitha skemave pensionale, duke forcuar kontrollet e TI-së, përcaktimin e përgjegjësive dhe komunikimin adekuat ndërmjet njësisë së TI-së dhe menaxhmentit për zhvillim dhe menaxhim më efikas të sistemeve.

4. **Kodi burimor dhe vazhdimësia e sistemit.** MPFVLÇ duhet të forcojë procesin e planifikimit dhe menaxhimit të projekteve TI-së, duke përfshirë analizë të detajuar të rreziqeve teknike dhe kontraktuale para nënshkrimit të marrëveshjeve, në mënyrë që të sigurohet që në të ardhmen të mos krijohen situata të varësisë nga palët e treta dhe të garantohet pronësia e kodit burimor dhe kontrolli institucional mbi sistemet kritike.

5. **Menaxhimi ndërinstitucional i të dhënave të arkivuara për pensionet kontributpaguese.** Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës duhet të përshpejtojnë procesin e transferimit të plotë të dokumentacionit arkivor të pensioneve kontributpaguese, nga Agjencia Kosovare e Privatizimit duke përfshirë përfundimin e transferimit të arkivave nga regjionet e Prishtinës dhe Gjilanit.

   5.1. Paralelisht, është e nevojshme të vazhdohet me digjitalizimin e plotë të materialeve arkivore, veçanërisht të dosjeve të ish-ndërmarrjeve shoqërore, me qëllim krijimin e një sistemi të plotë elektronik të qasshëm për institucionet dhe qytetarët.

   5.2. Gjithashtu, duhet të forcohet koordinimi ndërinstitucional mes AShAK dhe MPFVLÇ, për krijimin e ndërlidhjes së të dhënave pensionale të qasshme për institucionet dhe qytetarët.

6. **Validimi i të dhënave hyrëse në sistemin e Pensioneve.** MPFVLÇ duhet të sigurojë modernizimin e sistemit të pensioneve dhe krijimin e ndërlidhjeve automatike me sistemin e Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe institucionet bankare, në mënyrë që validimi i identitetit, statusit jetësor dhe të dhënave bankare të kryhet në kohë reale gjatë regjistrimit dhe para ekzekutimit të pagesave, duke eliminuar ndërhyrjet manuale.

7. **Regjistrimi i konfirmimit 6-mujor të pensionit.** MPFVLÇ duhet të vendos kontrolle të detyrueshme në sistem për regjistrimin e saktë të konfirmimit 6-mujor të pensionistëve dhe të sigurojë ndërlidhje automatike me sistemet relevante shtetërore për verifikimin e statusit jetësor dhe rezidencës së përfituesve.

8. **Verifikimi ndërmjet skemave pensionale.** MPFVLÇ të krijoj një bazë të unifikuar qendrore për të gjitha skemat pensionale dhe të vendos kontroll automatik në sistem gjatë regjistrimit, në mënyrë që të verifikohet në kohë reale nëse qytetari është përfitues i ndonjë skeme tjetër, duke eliminuar kontrollin manual dhe duke rritur saktësinë e procesit.

9. **Aplikimet në platformën e-Kosova.** MPFVLÇ dhe MF duhet, që në bashkëpunim me AShI-në, të rishikojnë dhe përmirësojnë formularët elektronikë në platformën e-Kosova për të siguruar që të gjitha të dhënat dhe dokumentet e nevojshme të plotësohen saktë para dorëzimit të aplikimit, si dhe të hartojnë dhe zbatojnë një procedurë të qartë për menaxhimin dhe dhënien e qasjeve për zyrtarët përgjegjës.

10. **Përpunimi i të dhënave për skemat pensionale.** MPFVLÇ duhet të sigurojë integrimin e plotë të të gjitha skemave pensionale brenda Sistemit Informativ për skemat pensionale (SII), duke eliminuar përdorimin e formave të ndara në Microsoft Access.

    10.1. Evidenca elektronike për vendimmarrjen e komisioneve të pensioneve. MPFVLÇ duhet të zhvillojë dhe implementojë funksionalitete në sistemin e pensioneve për regjistrimin dhe menaxhimin elektronik të vendimeve të komisioneve, duke përfshirë evidencën e vendimit, datën, arsyetimin dhe anëtarët e komisionit, me qëllim të rritjes së transparencës, gjurmueshmërisë dhe besueshmërisë së procesit të ndryshimit të kategorisë së pensionit.

11. **Mekanizmat për verifikimin e përfitimit të pensioneve nga shtete të tjera.** MPFVLÇ duhet të vendosë një mekanizëm për deklarimin dhe verifikimin e përfitimeve pensionale jashtë vendit, duke përfshirë këtë kërkesë si në procedurat administrative, ashtu edhe në Sistemin Informativ për skemat pensionale (SII), ashtu siç është e paparë edhe në kriteret që parasheh legjislacioni në fuqi.

12. **Kontrollet dalëse të aplikacionit për verifikimin e të dhënave për skemat pensionale.** MPFVLÇ duhet të vendosë mekanizma të detyrueshëm për verifikimin e llogarive bankare të përfituesve para ekzekutimit të pagesave, duke siguruar ndërlidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet Sistemit Informativ të unifikuar për të gjitha skemat pensionale dhe institucioneve bankare përmes ndërfaqeve të automatizuara (API). Kjo ndërlidhje duhet të mundësojë validimin në kohë reale të saktësisë dhe statusit aktiv të llogarive bankare.

13. **Praktikat e sigurisë së informacionit për menaxhimin e fjalëkalimeve.** MPFVLÇ duhet të vendosë dhe zbatojë një politikën për menaxhimin e fjalëkalimeve në Sistemit Informativ të unifikuar për të gjitha skemat pensionale, duke përfshirë kërkesa për kompleksitet minimal (gjatësi, kombinim shkronjash, numrash dhe simboleve), skadim periodik dhe ndalim të ripërdorimit të fjalëkalimeve.

    13.1. Paralelisht, duhet të implementohen mekanizma teknikë që sigurojnë enkriptimin e fjalëkalimeve dhe detyrimin e këtyre rregullave në nivel sistemi. Në kushtet e kufizimeve të sistemit ekzistues, Ministria duhet të ndërmarrë masa për modernizimin

dhe zëvendësimin e komponentëve të vjetruar të zhvilluar në Microsoft Access, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë.

13.2. Gjithashtu, duhet të zhvillohen aktivitete të rregullta të vetëdijesimit dhe trajnimit për zyrtarët mbi sigurinë e informacionit dhe përdorimin e sigurt të kredencialeve, në mënyrë që të reduktohet rreziku i qasjes së paautorizuar dhe mundësia e keqpërdorimit të sistemit.

14. **Gjurmueshmëria e aktiviteteve në sisteme dhe të bazën e të dhënave.** MPFVLÇ duhet të sigurojë implementimin e plotë të mekanizmave për regjistrimin dhe monitorimin e gjurmëve të auditimit për të gjitha nivelet e përdoruesve, përfshirë edhe përdoruesit me privilegje administrative, në Sistemin Informativ të unifikuar për të gjitha skemat pensionale dhe në të gjitha sistemet mbështetëse – bazë të të dhënave. Konkretisht, duhet të zhvillohet dhe vihet në funksion një modul i dedikuar për auditim dhe një log server për regjistrimin e sigurt dhe të pandryshueshëm të aktiviteteve.

14.1. Gjithashtu, duhet të vendosen procedura të rregullta për monitorimin dhe rishikimin e këtyre gjurmëve, si dhe të përcaktohen qartë përgjegjësitë për mbikëqyrjen e aktiviteteve administrative.

15. **Plani për kopjen rezervë, vazhdimësi të biznesit dhe rikthim nga fatkeqësitë.** MPFVLÇ duhet të hartojë dhe miratojë një politikë të plotë për kopje rezervë, vazhdimësi të biznesit dhe rikthim nga fatkeqësitë, e cila duhet të mbulojë edhe mjedisin aktual të Sistemit të Integruar Informativ (SII). Kjo politikë duhet të përfshijë procedura të qarta për rikthimin e të dhënave, përcaktimin e kohës maksimale të lejueshme të ndërprerjes dhe humbjes së të dhënave, si dhe përgjegjësitë institucionale për menaxhimin e incidenteve.

15.1. Gjithashtu, MPFVLÇ duhet të hartojë dhe testojë rregullisht një plan operativ për rikthim nga fatkeqësitë, në mënyrë që të sigurohet funksionalizimi i shpejtë i sistemit dhe vazhdimësia e shërbimeve në rast të ndërprerjeve apo humbjes së të dhënave.

SHIOJICAI

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit dhe materialiteti

Rëndësia e ekzistencës së skemave pensionale qëndron në faktin se ato garantojnë përfshirje sociale dhe drejtësi shoqërore, duke u mundësuar qytetarëve mbështetje të përshtatur sipas nevojave të tyre. Përmes tyre sigurohet që asnjë grup i ndjeshëm – si të moshuarit, personat me aftësi të veçanta, veteranët apo punëtorët e dikurshëm të sektorëve të rëndësishëm – të mos mbetet pa përkrahje. Këto skema përbëjnë një pjesë të rëndësishme të sistemit të mbrojtjes sociale në Kosovë dhe kontribuojnë në stabilitetin ekonomik dhe human të vendit.

Prandaj, për këtë kategori Republika e Kosovës ndan çdo vit buxhet shtetëror në një vlerë mbi 400 milionë euro.

Gjatë fazës parastudimore, pasi shqyrtuam dokumentet e MFPT-së për sistemet e TI-së dhe proceset e skemave pensionale, zhvilluam intervista me zyrtarët përgjegjës dhe u njohëm me procesin edhe në zyrën regjionale. Nga kjo analizë, identifikuam se, pavarësisht përpjekjeve për digjitalizimin e skemave pensionale dhe proceseve, MFPT ende përballet me disa sfida të rëndësishme, si:

- Mungesa e një sistemi të unifikuar për 13 skemat pensionale, pasi që ata kanë zhvilluar në vitin 2010 një ueb aplikacion vetëm për 3 skema dhe asnjëherë nuk është avancuar dhe nuk ka mirëmbajtje. Prandaj, zhvillimi në formë elektronike për skemat tjera është bërë përmes MS Access duke ruajtuar të dhënat e skemave pensionale në formë tabelare. Ky organizim i të dhënave vështirëson sinkronizimin e të dhënave për të gjitha skemat pensionale në të njëjtën kohë.
- Mungesa e të dhënave të digjitalizuara shkakton vonesa dhe poashtu pamundëson marrjen e pensionit kontributpagues në rast të mos posedimit të dokumenteve dëshmi. MFPT ka një sistem digjital që është zhvilluar para viteve të 90-ta (M4), por në këtë sistem nuk janë komplet të dhënat. Pjesa më e madhe e të dhënave janë në libra fizik, por të shpërndarë në zyre

regjionale dhe një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve për Ndërmarrjet Publike janë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

- Mungesë e ndërlidhjeve dhe validimit të të dhënave me sistemet dhe bazat e të dhënave tjera. MFPT, shkëmben në formë manuale të dhënat me institucionet tjera. Rastet e regjistrimit të vdekjes, rezidencës janë disa nga problemet që përballet MFPT si pasojë e mungesës së ndërlidhjeve.

Përveç këtyre mangësive ne kemi marr edhe rekomandimet dhe çështjet e identifikuara në raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të MFPT për vitin 2024 të realizuar nga ZKA31 që kishin të bënin me regjistrimin e vdekjeve, gjithashtu, për pensionet kontribut paguese ne kemi shqyrtuar edhe raportin e Avokatit të Popullit32.

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e çështjeve për sistemin e pensioneve, si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së33 për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar na orienton në problemin kryesor: sistemi i pensioneve ka mangësi në zhvillimin e proceseve në formë elektronike dhe digjitalizimin dhe unifikimin e të dhënave, si dhe kontrollin e aplikacionit.

31 Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Vitin 2024 (2025).

32 Raport me rekomandime Ex-officio nr.235/2018,në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues të moshës për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve si pasojë e largimit diskriminues nga puna.

33 Manuali Aktiv i Auditimit- është platformë e zhvilluar nga ITWG/EUROSAI dhe WGITA/INTOSAI, që përdoret për identifikimin e fushave më me rrezik, përcaktimin e pyetjeve, kritereve dhe metodologjisë së punës gjatë procesit të auditimit të TI-së.

Përshkrimi i sistemit

1.1 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), përkatësisht tani Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ), ka për mision të zhvillojë dhe zbatojë politika publike në fushën e financave publike, punës dhe mirëqenies sociale, përmes menaxhimit të resurseve financiare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, punësimit dhe mirëqenies sociale për qytetarët e Republikës së Kosovës. Struktura organizative e Ministrisë, është si vijon: Kabineti i Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Departamentet dhe Divizionet.

Në kuadër të MFPT janë 18 departamente. Për administrimin e skemave Pensionale, departamenti përgjegjës është Departamenti i Pensioneve dhe Departamenti për Menaxhimin e Sistemit të Teknologjisë së Informacionit. Të cilat i kemi paraqitur në figurën në Vazhdim.

Figura 1. Departamentet dhe divizionet përgjegjëse për administrimin e pensioneve dhe sistemit informativ të MFPT



1.1.1. Departamenti i Pensioneve

Departamenti i Pensioneve ka për mision hartimin e politikave publike në realizimin e të drejtave në pensione dhe benefite të tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor, përfshirë edhe kategoritë e dala nga lufta si dhe koordinimin dhe zbatimin e skemave pensionale të financuara nga shteti, përmes degëve lokale të saj.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Pensioneve, janë:

- Zhvillon politikat e sistemit pensional, invalidor, aftësisë së kufizuar dhe të kategorive të dala nga lufta;
- Zhvillon politikat e sistemit pensional në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Siguron sistem të qëndrueshëm afatgjatë pensional dhe invalidor, për siguri më të madhe ekonomike të përfituesve të të drejtave pensionale dhe invalidore, të aftësisë së kufizuar si dhe kategorive të dala nga lufta;
- Zhvillon analiza, projeksione financiare afatgjate dhe programe si bazë ekspertësh, për përcaktimin dhe zbatimin e politikës së sigurimit pensional dhe invalidor;
- Mbikëqyr drejtpërdrejtë zbatimin e akteve normative në fushëveprimin e Departamentit, dhe punën e degeve lokale;
- Udhëheq me procedurat për kthimin e mjeteve të tërhequra për kohë gjatë së cilës përfitimi nga skema nuk është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Administron skemat pensionale dhe invalidore përfshirë edhe skemat pensionale të kategorive të dala nga lufta, të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi;
- Koordinon planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit, për pensione dhe benefite të tjera;
- Menaxhon pagesat e pensioneve të përfituesve nga skemat pensionale dhe invalidore;
- Menaxhon dhe mirëmban regjistrat dhe statistikat për pagesat e pensioneve të përfituesve nga skemat pensionale dhe invalidore.

- Siguron zbatimin e procedurave për realizimin e të drejtave për pensione, për qytetarët e Kosovës që kanë punuar jashtë vendit dhe anasjelltas;
- Mirëmban dokumentacionin për të gjitha shpenzimet lidhur me shpërndarjen e pensioneve;
- Harton raportet e rregullta periodike nga fusha e pensioneve; dhe
- Monitoron zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit.

Në kuadër të Departamentit bëjnë pjesë divizionet, si në vijim:

- Divizioni për Politika Pensionale dhe Invalidore;
- Divizioni për Pensione të Jashtme;
- Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale; dhe
- Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale për Kategoritë e Luftës.

Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale, janë:

- Administron të gjitha skemat pensionale në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Administron, menaxhon dhe koordinon aktivitetet me Zyrat e Pensioneve, si degë lokale të Ministrisë;
- Menaxhon dhe mirëmban regjistrat e pagesave të skemave pensionale, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Siguron hapjen e llogarive bankare për përfituesit e skemave pensionale;
- Siguron zbatimin e marrëveshjeve dhe kontratave me bankat komerciale apo institucionet e tjera mikrofinanciare, për realizimin e pagesave të pensioneve.

1.1.2. Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative

Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative ka për mision të planifikojë, zhvillojë, administrojë, monitorojë, mirëmbajë dhe zbatojë

shërbimet efikase dhe efektive të teknologjisë informative për Ministrinë, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet e brendshme dhe të jashtme.

Në kuadër të Departamentit bëjnë pjesë divizionet, si vijon:

- Divizioni për Infrastrukturë dhe Sigurinë e TI-së;
- Divizioni për Operacione të TI-së; dhe
- Divizioni për Menaxhim të Aplikacioneve.

Divizioni për Menaxhim të Aplikacioneve

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Menaxhim të Aplikacioneve, janë:

- Menaxhon kërkesat për zhvillimin, avancimin, administrimin dhe ndryshimin e aplikacioneve të punës dhe zgjidhjen e problemeve me aplikacione
- Përgatit dhe përditëson dokumentimin teknik (specifikimet teknike) për zhvillim, administrimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha aplikacioneve softuerike;
- Organizon dhe mirëmban dokumentacionin e përditësuar teknik, për të gjitha aplikacionet operacionale të punës;
- Menaxhon ekipin që mbështet aplikacionet e punës;
- Bashkëpunon me grupin e biznesit lidhur me aplikacionet për identifikimin e fushave për përmirësimin, dizajnimin, administrimin dhe zhvillimin e aplikacioneve të reja;
- Përcakton kërkesat për infrastrukturë të TI-së gjatë zhvillimit të aplikacioneve të reja të punës, ose përmirësimit, avancimit të aplikacioneve ekzistuese;
- Përcakton standardet për platformat teknologjike për aplikacionet e punës dhe arkitekturën e aplikacioneve të punës, në pajtim me modelin arkitektonik të organizatës;
- Hulumton dhe inicion risitë, në lidhje me aplikacionet e punës, në pajtim me synimet dhe objektivat e punës;

- Hulumton, planifikon dhe propozon zgjidhje për sistemet e integruara në bazë të nevojave të punës, për shkëmbimin e të dhënave dhe ndërveprimin e sistemeve;
- Planifikon, menaxhon dhe administron të gjitha aplikacionet e reja, ato të përmirësuarat, ose zëvendësimin e aplikacioneve për: dizajnimit, zhvillimit/ ekzekutimit dhe zbatimit;
- Kryen testimin e hollësishëm të aplikacioneve të reja / funksioneve të reja, ose ndryshimeve të atyre ekzistuese, para vënies në funksion në bashkëpunim me biznesin;
- Zhvillon dhe mirëmban procedurat dhe politikat e përditësuara, lidhur me aplikacionet e punës të Ministrisë;
- Përcakton kërkesat vjetore buxhetore për aplikacionet e punës;
- Siguron përdorim të sistemeve të TI-së përmes identifikimit dhe organizimit të trajnimeve për përdoruesit e sistemit të TI-së, si dhe përgatitjes dhe përditësimit të manualeve, udhëzuesve teknikë për përdoruesit e sistemeve;
- Menaxhon qasjen në kodin burimor për sistemet e zhvilluara dhe të mirëmbajtura, në Divizionin e Aplikacioneve dhe
- Menaxhon mjediset e zhvillimit, mjedisin e testimit dhe mjedisin e drejtpërdrejtë (live), siç është e përcaktuar sipas standardeve ndërkombëtare për praktika korrekte.

1.2. Agjencia Kosovare e Privatizimit(AKP)

Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej "Agjencia") është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Bazuar në përmbajtjen e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), përgjegjësitë e Agjencisë lidhur me intertarizimin (arkivimin dhe ruajtjen) e dosjeve personale të punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara përfshihen në kuadrin e detyrimeve të saj për administrimin dhe menaxhimin e dokumentacionit të ndërmarrjeve nën autoritetin e saj.

Konkretisht, AKP është e ngarkuar me ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin e plotë të aseteve, dokumenteve dhe të dhënave të ndërmarrjeve shoqërore gjatë dhe pas procesit të privatizimit ose likuidimit.

Sipas nenit 18 të Shtojcës së Ligjit, Autoriteti i Likuidimit (i caktuar nga AKP) ka për detyrë të:

- krijojë dhe plotësojë regjistrin e aseteve dhe detyrimeve të ndërmarrjes,
- mbajë dhe ruajë të gjitha llogaritë dhe korrespondencën afariste të ndërmarrjes,
- marrë në posedim, grumbullojë dhe ruajë të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ato që lidhen me marrëdhëniet e punës.

Pra, AKP është institucioni përgjegjës për mbledhjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit personal të punëtorëve të ndërmarrjeve që janë privatizuar ose në proces likuidimi, deri në dorëzimin përfundimtar të këtyre materialeve në Arkivin Shtetëror të Kosovës ose autoritetin kompetent për ruajtjen e dokumenteve publike.

1.3. Arkivi Shtetëror i Kosovës

Arkivi Shtetëror i Kosovës (Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, AShAK) është institucioni shtetëror përgjegjës për organizimin, ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë dokumentare në Republikën e Kosovës. Ai pranon, evidenton, ruan dhe bën të mundur shfrytëzimin e lëndëve arkivore për qëllime hulumtuese, shkencore, profesionale dhe publike, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore (i mëvonshëm zëvendësuar nga Ligji Nr. 08/L-111), Arkivi Shtetëror ka masa specifike detyrash dhe përgjegjësish lidhur me dokumentet e arkivuara sipas nenit 13 të këtij ligji trajtohen edhe dokumentet e personelit të ndërmarrjeve shoqërore (që janë privatizuar):

- Sipas Ligjit, institucionet që marrin përsipër kompetenca publike, përfshirë personat juridik që operojnë me fonde publike kanë detyrimin ligjor të

krijojnë, ruajnë dhe dorëzojnë dokumentacionin e tyre arkivor te Arkivi kompetent.

- AShAK udhëzon, këshillon dhe ndihmon institucionet (fond krijuesit) për administrimin e dokumenteve: si t'i klasifikojnë, evidentojnë, ruajnë dhe mbrojnë ato nga dëmtimi, humbja apo keqpërdorimi.
- Arkivi miraton një listë të kategorizimit për ruajtjen e dokumenteve, që përcakton vlerën arkivore dhe afatet kohore për ruajtje dhe shfrytëzim.
- Për qasjen në materialet arkivore, ligji parashikon rregulla: pas një afati (zakonisht 30 vjet), dokumentet mund të japin për shfrytëzim, por për dokumentet që përmbajnë të dhëna personale ka afate speciale (p.sh. 60 vite nga momenti i krijimit, apo deri pas 10 viteve nga vdekja e personit fizik) për të mbrojtur privatësinë.

Në këtë mënyrë, Arkivi Shtetëror i Kosovës siguron që edhe dokumentet e dosjeve të personelit të ndërmarrjeve shoqërore - të privatizuara të ruhen si pasuri arkivore, por edhe që të mos ekspozohen pa kriter, duke kombinuar qasje publike me mbrojtje të të dhënave personale.

Fushat e auditimit dhe pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në fushën kontrollet e aplikacionit, si dhe çështje që lidhet me zhvillimin dhe blerjen dhe duke i përzgjedhur fushat e auditimit si në vijim:

1. Zhvillimi dhe Blerja

1.1. Zhvillimi dhe menaxhimi i kërkesave

2. Kontrollet e Aplikacionit

2.1. Kontrollet e hyrjes

2.2. Kontrollet e përpunimit

2.3. Kontrollet e të dhënave dalëse

2.4. Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

Pyetjet audituese

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. A i plotëson kërkesat e Ministrisë sistemi i skemave pensionale për digjitalizim të plotë të procesit?
2. A siguron sistemi i skemave pensionale të dhëna në kohë reale?
3. A siguron sistemi i skemave pensionale integritetin, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave gjatë gjithë ciklit të përpunimit të transaksioneve?
4. A siguron sistemi i skemave pensionale që informacioni i gjeneruar të jetë i plotë dhe i saktë para përdorimit të mëtejmë dhe që të mbrohet në mënyrë të duhur?
5. A futen të dhëna të vlefshme në sistemin e skemave pensionale vetëm nga personeli i autorizuar?
6. A mbrohet informacioni i sistemit të skemave pensionale në mënyrë të duhur kundër keqpërdorimit?

Kriteret e auditimit

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së[34], si dhe ligji dhe aktet nën ligjore në fuqi për skemat pensionale në Kosovë.

Për të vlerësuar se për zhvillimin e sistemit të integruar informativ për skemat pensionale janë plotësuar kërkesat dhe nevojat e biznesit për digjitalizimin e procesit janë vendosur kriteret e mëposhtme:

34 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAI-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

- MFPT analizon, prioritizon dhe menaxhon kërkesat e zhvillimit të sistemit që të sigurojë se nevojat e MFPT-së për digjitalizimin e procesit për ofrimin e skemave pensionale janë plotësuar në mënyrë efektive dhe optimale.[35]

Për të vlerësuar se për sistemin e integruar informativ për skemat pensionale ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë plotësinë, saktësinë dhe qasjen e sigurt në sistemin informativ janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Rregullat e vlefshmërisë në sistemin e pensioneve duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së tejkalimit të kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.[36]
- Transaksionet e aplikacionit duhet të ekzekutohen në përputhje me sjelljen e pritur.37 Duke u bazuar në legjislacionin dhe aktet tjera nën ligjore lidhur me skemat pensionale.[38]
- MFPT duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.[39]

35 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Informacioni dhe Siguria Kibernetike, Zhvillimi dhe Blerja.
36 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.
37 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e përpunimit.
38 Ligji Nr.08/L-248 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 04/L-131 Për Skemat Pensionale Të Financuara Nga Shteti; Udhëzim Administrativ Mfpt Nr. 03/2022; Udhëzimi Administrativ (Mpms) Nr. 09/2015; Rregullore (Mfpt) Nr. 01/2025; Rregullore (Qrk) Nr.23/2024;
39 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse.

- Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrolle efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për të siguruar autentifikimin, autorizimin dhe monitorimin e aksesit. Gjithashtu, aplikacioni duhet të ketë një plan të dokumentuar për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, duke përfshirë mekanizma të sigurt të backup-it dhe rikuperimit, sipas domainit mbi PVB/PRF. Planet e sigurisë dhe rimëkëmbjes duhet të testohen rregullisht për të garantuar vijueshmërinë e biznesit dhe mbrojtjen e informacionit.[40]

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve, në kuadër të këtij Departamenti përfshihen edhe zyrat regjionale që dy prej tyre do të jenë pjesë e fushëveprimit Prishtina në fazën planifikuese dhe tjetra (Prizreni) në fazën kryesore të ekzekutimit në teren, si dhe Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative në MFPT. Gjithashtu, në fushëveprim është edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për rolin e saj në ruajtjen dhe inventarizimin e dosjeve të punëtorëve në Ndërmarrjet Shoqërore të Kosovës ku procesi i privatizimit të tyre është menaxhuar nga kjo Agjenci, si dhe Arkivi Shtetëror i Kosovës për rolin e tij në procesin e dokumenteve të arkivuara.

Fokus i auditimit është zhvillimi dhe kontrollet e aplikacionit për sistemin e teknologjisë së informacionit, Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale. Auditimi mbulon periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2026.

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit zbatojmë metodologjinë në vijim:

40 Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

- Rishikimi dhe analizimi i dokumenteve kontraktuale. Kontratën fillestare për zhvillimin e ueb platformës të sistemit për pensionet. Kërkesat e MFTP-së (ana e biznesit për zhvillimin e funksioneve), vendimet qeveritare lidhur me pensionet. Kërkesat e TI-së lidhur me zhvillimin dhe avancimin e sistemit. Raportet për zhvillimin e kërkesave.
- Rishikimi i kërkesave dhe rregullave të biznesit për MFPT-në. Analizimi i llojeve të të dhënave hyrëse. Kërkesat ligjore dhe të përputhshmërisë me rregulloret e jashtme. Struktura e ndërlidhjeve të të dhënave me sisteme të tjera. Diagramet e rrjedhës së sistemit. Manualet e përdoruesit. Rregullat e verifikimit.

  Verifikimi nëse kontrollet e validimit për futjen e të dhënave po zbatohen, duke vëzhguar përdoruesit e aplikacionit gjatë veprimit të tyre real; analizimi i regjistrave të të dhënave të ruajtura në bazën e të dhënave përmes përdorimit të veglave të auditimit.

  Vlerësim nëse kriteret dhe parametrat e validimit mbi të dhënat e inputit përputhen me rregullat e biznesit dhe nëse zbatojnë refuzimin e tipeve të inputit që nuk përputhen. Operatorët e bazës së të dhënave (si *, =, or, select) duhet të ndalohen si input të vlefshëm, pasi mund të përdoren për të ndërprerë ose për të marrë informacion nga baza e të dhënave.

  Intervistohen menaxherët nëse kriteret dhe parametrat e validimit mbi të dhënat e inputit rishikohen periodikisht, konfirmohen dhe azhurnohen në mënyrë të autorizuar dhe të përshtatshme.

  Rishikimi i diagramave të rrjedhës së sistemit dhe kodi i sistemit, dhe të intervistohen zhvilluesit ose administratorët e aplikacionit për të marrë informacion mbi ndërfaqet dhe kontrollet mbi to.

- Rishikimi i dokumentacionit të Sistemit të Pensioneve. Rregullat dhe kërkesat e biznesit. Diagrami i rrjedhës së të dhënave. Lista e transaksioneve me rëndësi të lartë. Kodi burimor.

  Të rishikohet dokumentacioni i aplikacionit për të verifikuar që është i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për proceset biznesore. Kur është e nevojshme, për transaksionet kritike, të rishikohet kodi për të konfirmuar që kontrollet në mjetet dhe aplikacionet funksionojnë sipas dizajnit. Të

ripërpunohen mostra përfaqësuese për të verifikuar që mjetet automatike operojnë siç është parashikuar.

- Rishikimi i Listave të output-eve/raporteve elektronike. Mostër e output-it elektronik.

  Analizohen listat e të gjitha daljeve elektronike që ripërdoren në aplikacionet e përdoruesve fundorë tek regjionet dhe zyrat e pensioneve. Verifikimi që dalja elektronike testohet për plotësinë dhe saktësinë e saj para se të ripërdoret dhe të ripërpunohet. Analizimi i bilancit dhe pajtueshmëria e daljes siç është përcaktuar nga metodat e dokumentuara. Zgjedhet një mostër përfaqësuese e daljes elektronike dhe gjurmohen dokumentet e përzgjedhura gjatë procesit për të siguruar që plotësia dhe saktësia janë verifikuar para se të kryhen operacione të tjera. Ripërpunohen testet e plotësisë dhe saktësisë për të verifikuar që ato janë efektive. Shqyrtohet nëse çdo produkt dalës përmban: emrin ose numrin e programit të përpunimit; titullin ose përshkrimin; periudhën e përpunimit të mbuluar; emrin dhe vendndodhjen e përdoruesit; datën dhe kohën e përgatitjes; klasifikimin e sigurisë.

- Rishikimi i dokumentacionit teknik të Sistemit Informative të Integruar me detajet e zbatimit.

  Rishikimi dokumentacioni i disponueshëm i zgjidhjes software/hardware dhe të intervistohet ekipi TI-së i MFPT për të vlerësuar kuptimin e tyre mbi mekanizmat e sigurisë të implementuar në aplikacion.

Dokumentet relevante

Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës ka miratuar ligje dhe udhëzime administrative të cilat përcaktojnë përgjegjësitë si dhe procesin e funksionimit të Skemave Pensionale në Institucionet e Republikës së Kosovës.

2.1 Ligjet

Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Ky ligj rregullon dhe përcakton: pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut paguese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti.

Ligji Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Qëllimi i Ligjit Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti është si vijon:

- Përditësimi i ligjit bazik për skemat pensionale që financohen nga shteti.
- Shtimi i përkufizimit të "rezidentit", duke përcaktuar se personi duhet të qëndrojë në Kosovë mbi 183 ditë në çdo periudhë 12 mujore.
- Krijimi i skemës së re "pensioni parcial kontributpagues i moshës", për personat që kanë paguar kontribute para vitit 1999, por nuk kanë arritur 15 vjet stazh për shkak të masave të dhunshme.

2.2 Udhëzimet Administrative

Udhëzim Administrativ MFPT Nr. 03/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (Mpms) Nr. 05/2015 për Lajmërimin, Suspendimin nga Pagesa Dhe Kthimin e Mjeteve në Rastet e Keqpërdorimit të Pensioneve

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 05/2015 për Procedurat e Lajmërimit, Suspendimin nga Pagesa dhe Kthimin e Mjeteve në Rastet e Keqpërdorimit të Pensioneve (më tutje referuar si "Udhëzimi bazë").

Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontibuteve –Stazhit Pensional

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe kriteret për kategorizimin e pensionistëve kontributpagues, duke u bazuar në strukturën kualifikuese dhe kohëzgjatjen e pagesave të kontributeve pensionale.

Ky Udhëzim, iu dedikohet të gjithë pensionistëve aktual dhe atyre të cilët aplikojnë për herë të parë në pension kontributpagues të përcaktuar me Ligjin në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

2.3 Rregulloret

Rregullore (MFPT) Nr. 01/2025 për Funksionimin e Komisionit Mediko-Social

Kjo Rregullore, ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të Komisionit MedikoSocial, për vlerësimin e shkallës së verbërisë dhe vlerësimin e nevojave sociale për personat e verbër, si dhe përcaktimin e procedurave të aplikimit, kritereve për realizimin e të drejtave të përcaktuara me legjislacionin përkatës për të verbër.

Rregullore (Qrk) Nr.23/2024 për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimt dhe Njohjes së Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e kritereve dhe procedurave për vlerësimin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe njohjen e të drejtave të tyre në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë.

Shtojca II. Letër konfirmimet

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE I NATIONAL AUDIT OFF.

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Dos. Klasif. Hiros. Kod Cl. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Faqeve Br. Stranica Nr. Pages
06	47	1206	1

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria-Vlada-Government
MINISTRIA PËR PUNË, FAMILJE DHE VLERAT E LUFTËS ÇLIRIMTARE
MINISTARSTVO ZA RAD, PORODICU I VREDNOSTI OSLABODILAČKOG BORBE
MINISTRY OF LABOUR, FAMILY AND VALUE OF THE LIBERATION WAR
Nr. Protokolli 7 04/2026
Data/Datum 01.07.26

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačke Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit **Sistemi i Integruar Informativ për skemat pensionale,** dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Vendi dhe data: Prishtinë 01.07.2026

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **Sistemi i Integruar Informativ për skemat pensionale** (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Bujar SADIKU

Sekretar i Përgjithshëm MPFVLÇ

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës